

### III. DEPARTAMENTI I KONTROLLIT TË INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE ME FINANCIME TË HUAJA

#### 1. KONTROLL NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE, PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI DHE SUPERVIZIONI I SEGMENTIT RRUGOR GJIROKASTËR-TEPELENË”

Në zbatim të programit të kontrollit u ushtrua kontroll në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për projektin “Ndërtimi dhe supervizioni i segmentit rrugor Gjirokastër-Tepelenë”, me objekt kontrolli: “Mbi kontrollin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të projektit Ndërtimi dhe Supervizioni i Segmentit Rrugor Gjirokastër-Tepelenë”.

Kontrolli u krye nga data 10.09.2007 deri më datën 31.10.2007, sipas drejtimeve të përcaktuara në këtë program kontrolli, për periudhën e zbatimit të projektit.

Në vijim, trajtohen me radhë të gjitha pikat e kontrolluara në përputhje me përcaktimin e bërë në programin e kontrollit, e më konkretisht:

*Mbi kontratën financiare me huadhënësin dhe ndryshimet e saj në se ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit si dhe raportimi në ministrinë përkatëse, për periudhën e zbatimit të projektit*

I. Më datë 08.12.2000, ndërmjet BEI (Banka Evropiane e Investimeve) përfaqësuar nga zëvendëspresident në Grand-Duchy të Luksemburgut dhe Qeverisë Shqiptare, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Transporteve, në kuadër të Marrëveshjes Evropiane dhe vendimit të këshillit 2000/24, të 22 dhjetor 1999, ku Bordi i Guvernatorëve të Bankës autorizoi më 28.03.2000 dhënien e huave për projekte investimi në Shqipëri, është lidhur kontrata financiare nr. 20 853, për një projekt për ndërtimin dhe përmirësimin e rreth 86 km rrugë në korridorin kryesor kombëtar të vendit veri-jug.

Kosto totale e projektit është vlerësuar nga banka 71 milionë euro, e cila do të financohet si më poshtë:

Fondet e vetë huamarrësit	9,5 milionë euro
Grandi-BE-PHARE	7,5 milionë euro
Huaja italiane	20 milionë euro
Huaja e bankës	34 milionë euro
<b>Totali</b>	<b>71 milion euro</b>

Shuma prej 34 milionë euro e vendosur në kontratën financiare, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, i përket tre projekteve: segmentit Lushnjë-Fier, Fier-Vlorë dhe Tepelenë-Gjirokastër.

Huamarrësi ka rënë dakord që interesi dhe të gjitha pagesat e tjera ndaj Bankës, si dhe të gjitha pasuritë dhe të ardhurat e Bankës, që lidhen me këto aktivitete, do të përjashtohen nga Taksat.

Në lidhje me disbursimin e kredisë nga ana e Bankës në shumën 34 milionë euro, në nenin 1.02 përcaktohet se asnjë kërkesë nuk do të bëhet më vonë se data 15 dhjetor 2006. Sipas nënparagrafit 1.02 c, çdo kërkesë është e parëvokueshme.

Bazuar në Planin A, pjesë e kësaj marrëveshjeje “Përshkrimi teknik”, për Projektin e Rrugëve Evropiane-Shqipëria, projekti përfshin projektimin,

shpronësimin, supervizionin, përmirësimin, rindërtimin dhe komisionin e seksioneve të rrugëve prioritare përgjatë pjesës ekzistuese jugore veri-jug drejt kufirit grek. Seksioni B Tepelenë-Gjirokastër, **24 km**. Standardet e projektimit janë përcaktuar, si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Tepelenë-Gjirokastër
1	Gjerësia e korsive standard	2X3.50m
2	Gjerësia e korsive minimumi	2X3.00m
3	Shpatulla me shtresë asfaltime standard	2X0.75m
4	Shpatulla normale standard	2X1.25m
5	Shpatulla normale minimumi	2X0.75m
6	Gjerësia e platformës	7.50 – 11m

Kosto e vlerësuar e projektit për punimet e segmentit rrugor Tepelenë-Gjirokastër është 17.3 milionë euro. Këto punime ishin parashikuar të fillonin në fillim të vitit 2002 dhe seksioni B pritej të përfundonte nga fundi i vitit 2003.

Kjo kontratë dhe format e saj, ndërtimi dhe vlefshmëria do të drejtohen në bazë të përcaktimit të bërë në nenin 11 “Ligji dhe juridiksioni”, nga ligjet e Dukeja e Madhe e Luksemburgut.

Me ligjin nr. 8881, datë 18.4.2002 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për Projektin e Rrugëve Evropiane-Shqipëria” (BEI) u bë ratifikimi i kësaj kontrate financiare për shumën 34 milionë euro në Kuvend. Ky ligj është dekretuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me dekretin nr. 3312, datë 29.4.2002.

Më datë 10.10.2005 ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri i Financave dhe BEI-t është lidhur marrëveshja për shtojca dhe ndryshime në kontratën financiare, ku për shkak të ndryshimeve në projekt që kanë lidhje me seksionin rrugor Tepelenë-Gjirokastër, kosto e parashikuar e këtij seksioni është rishikuar duke pësuar një rritje nga 25.7 milionë euro, e parashikuar fillimisht në 28.5 milionë euro.

Seksioni B i kontratës së mëparshme është zëvendësuar me seksionin A1 të kontratës së re, me emërtimin “Përshkrimi teknik”, me ndryshimin që projekti përfshin zotërimin e tokës, supervizionin dhe përmirësimin në shtratin e rrugës ekzistuese të **23.7 km shtrat rruge** mes Gjirokastrës dhe Tepelenës (seksioni B), që lidhet me Greqinë nëpërmjet një aksi kryesor veri-jug.

Ky seksion do të përmirësohet me një gjerësi platforme, respektivisht prej 9.50 m ose 10.50 m

Standardet e projektimit janë përcaktuar si tabela më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Nënseksioni Gjirokastër-Hormova	Nënseksioni Hormova-Tepelenë
1	Shpejtësia	80km/orë	60km/orë
2	Gjerësia e shtratis të rrugës	2X3.75m	2X3.50m
3	Bankinat e kalueshme	2X1.50m	2X1.25m
4	Bordura	2X0.50m	2X0.50m
5	Gjerësia e platformës	10.50m	9.50m

Përsa i përket strukturës rrugore, kjo nuk ka pësuar ndryshime, ndërsa kosto totale e rishikuar për projektin, e parashikuar nga Banka është 28.5 milionë euro.

Kalendari për seksionin B në marrëveshjen për shtojca dhe ndryshime në kontratën financiare, ka shtyrë periudhën e përfundimit të ndërtimit, nga dhjetori i vitit 2003 në prill të vitit 2007.

Marrëveshja e lartpërmendur është ratifikuar në Kuvend me ligjin nr. 9435, datë 20.10.2005 për ratifikimin e "Marrëveshjes për shtesa dhe ndryshime në kontratën financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për Projektin e Rrugëve Evropiane-Shqipëria". Dekretimi nga presidenti i Shqipërisë është bërë me Dekretin nr. 4689, datë 07.11.2005.

Në lidhje me raportimet e bëra në Ministrinë e Financave, nga kontrolli u konstatua se për periudhën e kontrollit, nga ana e PIT-it është raportuar në Ministrinë e Financave për periudhat e mëposhtme:

- Me datë 08.08.2007, për periudhën janar-korrik 2007;
- Me datë 05.09.2007, për periudhën janar-gusht 2007;
- Me datë 05.10.2007, për periudhën janar -shtator 2007.

Për periudhat e mëparshme nuk na u paraqit dokumentacion që vërteton raportimet e bëra çdo datë 5 të çdo muaji për transaksionet financiare, në përputhje me VKM nr. 116, datë 24.02.1997 "Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Republikës së Shqipërisë" dhe udhëzimin nr. 8, datë 17.02.2003 të Ministrisë së Financave "Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj", për të cilën përgjegjësi mban drejtori i PIT-it.

Për sa më lart është mbajtur aktverifikimi nr. 1, datë 05.11.2007.

### ***Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje***

Rruga Gjirokastër-Tepelenë është pjesë e korridorit veri-jug. Projekti konsiston në modernizimin e 22.5 km në gjatësi, duke filluar nga kilometri i 3-të në veri të qytetit të Gjirokastrës dhe financohet nga BEI dhe programi Phare.

Duke marrë parasysh topografinë dhe gjeomorfologjinë e sipërfaqes, një mund të konsiderohet kilometri 10+900 si pikë nisje për miratimin e dy standardeve të ndryshme gjeometrike për dy sektorët e përshtatshëm si vijon:

Sektori 1: Nga km 0+000 (3km në veri të Gjirokastrës) deri në km 10+900

Sektori 2: Nga km 10+900 deri në km 22+500 (në jug të Tepelenës)

Bazuar në raportin progresiv mujor nr. 25, shtator 2007, programi i performancës do të bazohet mbi gurin kilometrik në vijim:

a. Seksioni nga km 0+000 deri km 12+000 (53% e gjithë gjatësisë së projektit) duhet të përfundojë deri më 15.10.2007;

b. Seksioni nga km 12+000 deri km 16+200, km 16+700 deri km 17+275 dhe km 18+260 deri km 22+500 duhet të përfundojnë nga fundi i dhjetorit 2007 (totali i gjatësisë është 9 km, përfaqëson 40% të gjatësisë së kontratës);

c. Seksioni nga km 16+200 deri km 16+700 (sipërfaqe toke e rrëshqitshme) dhe km 17+275 deri km 18+260 (sipërfaqe e mbrojtur) duhet të përfundojë më 15.04.2007 (gjatësia totale është 1.5 km, që përfaqëson 7% të gjatësisë së kontratës)

Supervizori konfirmon se seksioni (A) km 0+000 deri km 12+000, është në thelb i përfunduar dhe mund të dorëzohet mbi bazë të autoritetit kontraktues më 15.10.2007.

Referuar grafikut të ecurisë së punimeve, rezulton se janë përfunduar aktivitetet në zërat e mëposhtëm:

- Mbikëqyrje e rrugës dhe studimi topografik me nënzërat:
  - Etapat/monumentet;
  - Linjat qendrore;

- Seksionet e kryqëzimit
- Vizatimet e plan/profile dhe seksione të kryqëzimit
- Qartësimi i vendndodhjes
- Punime tokësore
- (vetëm për mbushjet dhe subgrade)
- Shtresë e kordonit të asfaltit
- Shtresë e veshjes së asfaltit
- Kanalet e drenazhimit dhe ujitjes me nënzërat
- Kanale anësorë të vijëzuar
- Kanale vaditës ose ndërprerje kanali
- Mure mbajtës
- Mure për vendosje shtyllash elektrike
- Punime për mbrojtjen nga pjerrësia me nënzërat përkatës
- Nga km 11+000 në km 22+150

Ndërsa vazhdon puna në aktivitetet e mëposhtme:

- Punime tokësore
- Për prerjet
- Thërrmimi i gurëve të poshtëm
- Asfaltimi i shtresës së poshtëme
- Kanalet e drenazhimit dhe ujitjes me nënzërin
- Betonim i tubave dhe kuti për kanalet
- Ura në km e 15
- Punime për mbrojtjen nga pjerrësia në km e mëposhtëm:
- Nga km 14+040 deri në km 15+290
- Nga km 22+350 deri në km 22+500

Progresi në ritmet e punës së kontraktorit kryesisht i referohet punimeve në asfalt dhe punimeve tokësore. Kjo ka bërë të mundur përfundimin e seksionit rrugor nga km 0 deri në km 12 + 000, duke e lejuar kontraktorin të kërkojë miratimin e pjesshëm për këtë seksion të rëndësishëm për 15.10.2007, duke arritur rreth 53% të kontratës.

Në lidhje me urat ka përfunduar në masën 95% ura e Belicës në km 4 + 465, duke mbetur shenjat e rrugës dhe pastrimi i copërave nga poshtë urës. Ura në km 14 + 588.32 ka përfunduar në masën 70%, duke mbetur dyshemeja prej betoni, trotuari, shtrimi me asfalt, parmakët dhe shenjat e rrugës. Ura në km 15+286.9 është përfunduar 95%, duke mbetur shenjat e rrugës dhe pastrimi i vendqëndrimit.

Në lidhje me punimet e asfaltimit, këto janë përfunduar për seksionin rrugor nga km 0+000 deri në km 12+000

Në lidhje me kanalizimet janë vendosur 265 m tuba kanalizimesh, 82 kuti kanalesh dhe 4 kuti kanalesh janë ndërtuar pjesërisht.

Kanalet e vaditjes janë përfunduar në masën 98%.

***Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar***

- Pagesat e bëra për konsulentin nga data 26 dhjetor 2005 deri më datë 29 gusht 2007 janë gjithsej në shumën prej 12.9 milionë euro.

- Pagesat e bëra për konsulentin nga data 20 maj 2003 deri më datë 2 gusht 2007 janë në shumën 1.8 milion euro.

Kërkesa e parë për çeljen e disbursimit nga konsulenti është bërë më datë 10 prill 2003 në shumën 434 546 euro për pagesën paraprake.

Disbursimi i parë për konsulentin është bërë më datë 20.05.2003 në shumën 170 000 euro.

- Në vitin 2003 janë disbursuar 434 546 euro.
- Në vitin 2004 janë disbursuar 230 000 euro.
- Në vitin 2005 janë disbursuar 2 572 684 euro.

Për të tre vitet 2003, 2004 dhe 2005 nuk ka pasur kosto lokale.

- Në vitin 2006 janë disbursuar 6 427 429 euro. Gjatë këtij viti, kosto lokale për t.v.sh. ka qenë 163 674 833 lekë.

- Në vitin 2007 janë disbursuar 4 773 841 euro. Gjatë këtij viti, kosto lokale për t.v.sh. ka qenë 99 999 953 lekë.

Disbursimet për projektin “Ndërtimi dhe supervizioni i segmentit rrugor Gjirokastër-Tepelenë”, sipas kategorive paraqiten në tabelën e mëposhtme:

- Për zërin “*punime civile*” është lidhur kontrata me kontraktorin në shumën 22 722 134 euro, deri tani janë disbursuar 12 931 037 dhe është realizuar në masën 56.91%.

- Për zërin “*konsulencë*” është lidhur kontrata me konsulentin. Për këtë kontratë janë bërë 2 shtesa me një vlerë të përgjithshme prej 2 407 077 euro, deri tani janë disbursuar 1 813 454 euro dhe rezulton e realizuar në masën 75.34%.

Deri në fund të muajit tetor të viti 2007, grandit – BE-PHARE është disbursuar plotësisht, kurse në tabelën e mëposhtme paraqitet disbursimi sipas donatorit BEI.

Nr. aplikimeve	Data e disbursimit	Disbursuar shuma në euro	Shuma e kredisë e padisbursuar
			19 000 000
1	21.10.2005	1 722 214	17 277 786
2	11.01.2006	2 500 000	14 777 786
3	04.07.2006	3 500 000	11 277 786
4	03.09.2007	3 000 000	8 277 786
	<b>Totali</b>	<b>10 722 214</b>	<b>8 277 786</b>

Nga tabelat e mësipërme tregohet se niveli i disbursimeve është i ulët, sidomos nga fillimi i projektit deri në vitin 2005, kjo për arsye të ecurisë së punimeve dhe ndryshimeve të afateve të përfundimit të punimeve, afate këto të miratuara nga organet përkatëse.

Në lidhje me shumat e rimbursimeve për t.v.sh., për vitet 2006 e 2007, nga kontrolli rezultoi se:

- Për vitin 2006 shuma për rimbursimin e t.v.sh. është rreth 164 milionë lekë.

- Për vitin 2007 deri më datë 19 shtator 2007, shuma e t.v.sh. së rimbursuar është rreth 100 milionë lekë.

Pra gjithsej për dy vitet rezulton të jetë rimbursuar për t.v.sh., rreth 264 milionë lekë.

*Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësin ose legjislacionin shqiptar për realizimin e prokurimeve për ndërtime, shërbime e mallra*

Në lidhje me kontrollin e ligjshmërisë së zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtimi i seksionit Gjirokastër-Tepelenë të korridorit veri-jug”, zhvilluar në datë 15.12.2004, me gjithë këmbënguljen tonë nga ana e DPRR ky dokumentacion jo i plotë dhe fotokopje na u vu në dispozicion me shumë vonesë, duke sjellë mosrealizimin e kontrollit për këtë çështje.

Më konkretisht një pjesë e dokumentacionit na u vu në dispozicion në datat 16, 17 dhe 18.10.2007, i cili rezultoi me mungesa të theksuara, dokumentacioni nuk ishte i inventarizuar numerikisht, çka përbën shkelje të nenit 36, kreu V “Arkivat e numerizuar”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, për të cilën përgjegjësi mbajnë arkivistet.

Mosvënia në dispozicion e materialeve të kërkuara, nga ana KLSH përbën shkelje të nenit 17 “E drejta e disponimit të dokumenteve dhe informacionit”, të ligjit nr. 8287, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshime, shkelje kjo e trajtuar në procesverbalin nr. 1, datë 09.10.2007.

### *Mbi zbatimin e kontratave të punimeve civile*

Për ndërtimin e segmentit rrugor Gjirokastër-Tepelenë është përcaktuar që, duke qenë se ky segment nga km 0+00 (3 km në veri të Gjirokastrës) deri në km 10+260, rruga ekzistuese ndjek lumin Drinos në një terren të rrafshët dhe nga km 10+260 deri në km 23+700 (Tepelenë) shtrihet në terren malor me pjerrësi të ndryshme, edhe parametrat e tij do të projektohen të ndryshme nga segmenti 10+260 deri në km 22+500. Kështu për pjesën e parë është përcaktuar që shpejtësia e projektuar të jetë nga 80 deri në 100 km/h me gjerësi të rrugës 10.5 m, ndërsa për pjesën e dytë shpejtësi të projektuar 60 deri 80 km/h dhe gjerësi të rrugës 9.5 m.

Parametrat e projektimit janë zbatuar në standardet italiane CNR. Vlera e parashikuar e projektit është 27 088 178.17 euro.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, për këtë projekt nuk është marrë leja e ndërtimit, veprim që bie në kundërshtim me nenet 38 dhe 4, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”.

Gjithashtu, nuk është realizuar oponenta teknike, veprim që bie në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 9, në të cilin përcaktohet se “Oponenta teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve”.

Në dispozicion të grupit të kontrollit nuk u vu dokumentacioni i studimit të fizibilitetit, raportet progresive mujore të konsulentit nga fillimi i punimeve deri në muajin shtator 2006. *Për këtë veprim përgjegjësi mban drejtori i PIT.*

Kontrata e punimeve civile “Rikonstruksion i rrugës Gjirokastër-Tepelenë”, seksioni i korridorit veri-jug është nënshkruar me datë 25.05.2005, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe shoqërisë pjesëmarrëse. Tenderimi për këtë projekt është bërë për gjithë fushën e zbatimit të punimeve, por në fazën e tenderimit sasia e fondeve në dispozicion nuk i përgjigjej zbatimit të plotë të punimeve të përcaktuara.

Në këto kushte, në varësi të fondeve në dispozicion, zbatimi i punimeve është ndarë në dy opsione:

#### ***Opsion 1:***

Nëse fondet do të vihen në dispozicion, punimet do të zhvillohen sipas dokumenteve të tenderit pa reduktim të fushës së zbatimit të punimeve, me vlerë 22 722 134.27 euro.

#### ***Opsion 2:***

Nëse nuk bëhet e mundur që fondi i plotë të vihet në dispozicion, punimet do të realizohen për një fushë të reduktuar të punimeve që do të limitohet për

seksionin e rrugës nga km 7.00 deri në afërsisht km 22+500. Punimet sipas këtij opsioni kapin vlerën 18 576 516.33 euro.

Afati i zbatimit të punimeve sipas kontratës, është përcaktuar 540 ditë. Në bazë të pikës 31.1.1 të kushteve speciale të kontratës, punimet duhet të fillojnë brenda 30 ditëve nga data e firmosjes së kontratës.

Punimet kanë filluar me datë 22 gusht 2005 dhe janë parashikuar të përfundojnë me datë 12 shkurt 2007. Gjatësia e rrugës që do të ndërtohet është 22.5 km, në varësi të gjerësisë është ndarë në dy seksione: seksioni 1 km 0+00 deri 10+900 me gjerësi 10.5 m dhe Seksioni 2 km 10+900 deri 22+500 me gjerësi 9.5 m. Sipas opsioneve, volumet kryesore të punimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi i punimeve	Opsion 1 km 0+00 deri 22+500	Opsion 2 km 7+00 deri 22+500
<b>1.Punime gjurmimi</b>		
Gërmim	808 000 m <sup>3</sup>	741 000 m <sup>3</sup>
mbushje	385 000 m <sup>3</sup>	325 000 m <sup>3</sup>
<b>2.Thyerje gurësh</b>	83 500 m <sup>3</sup>	57 500 m <sup>3</sup>
<b>3.Shtresë asfaltobetoni</b>	26 900 m <sup>3</sup>	18 500 m <sup>3</sup>
<b>4.Shtresë binderi</b>	16 000 m <sup>3</sup>	11 000 m <sup>3</sup>
<b>5.Asfaltobeton për veshje</b>	11 000 m <sup>3</sup>	7 611 m <sup>3</sup>
Urat		
<b>Përshkrimi i punimeve</b>	<b>Opsion 1</b> <b>km 0+00 deri 22+500</b>	<b>Opsion 2</b> <b>km 7+00 deri 22+500</b>
Beton	4 000 m <sup>3</sup>	800 m <sup>3</sup>
Armaturë hekuri	300 ton	55 ton
<b>6. mure mbajtës betoni</b>		
Beton	2 800 m <sup>3</sup>	2 800 m <sup>3</sup>
Armaturë hekuri	190 ton	190 ton

Me shkresë datë 27.4.2005, autoriteti kontraktor ka njoftuar kontraktorin për lidhjen e kontratës bazuar në opsionin 2. Më vonë, pas marrjes së informacionit për shtesë fondesh me shkresë datë 21.10.2005, ka njoftuar kontraktorin që ka vendosur të zbatojë opsionin 1.

Ecuria e punimeve sipas projektit paraqitet si më poshtë:

1. Sipas programit origjinal, për periudhën gusht 2005 deri dhjetor 2006.

Parashikuar	20 752 172.44 euro	96.99%
Realizuar	7 640 582.31 euro	36.25%
Diferenca	13 111 590.13 euro	(-) 60.74%

2. Sipas programit të rishikuar për periudhën janar 2007 deri qershor 2007.

Parashikuar	5 306 257.1 euro	61.05%
Realizuar	4 764 933.29 euro	57.98%
Diferenca	(-) 541 323.81 euro	(-) 3.07%

Në përgjithësi projekti është i vonuar në zbatim, ecuria e punimeve nuk është realizuar konform grafikut të punimeve, kjo krahasuar me programin origjinal si dhe me programin e rishikuar.

Arsyet kryesore të vonës në realizimin e punimeve sipas grafikut kanë qenë:

- Moszbatimi në afatet e përcaktuara i procedurave doganore.
- Vonesa e rishikimit të projektit për zonën e “Ujit të Ftohtë”, Tepelenë.
- Probleme të pazgjidhura për shpronësimet sidomos për zonën e “Ujit të Ftohtë”, Tepelenë.

- Modifikimi i skarpateve gjithashtu ka sjellë ndryshimin e planimetrisë së shpronësimeve.

- Në disa segmente kanalet kulluese sipër skarpateve janë jashtë planimetrisë së shpronësimeve.

- Mospagesa e pronarëve të përfshirë në listën e dytë të shpronësimeve, e cila ka lindur si nevojë e ndryshimeve të kufirit nga ndryshimet në projekt të cilësuar më sipër.

- Kushtet e papërshtatshme të motit.

Në disa raste praktikat doganore kanë shkaktuar vonesa. Bazuar në shkresën ***Përsa i përket zhdoganimeve*** e supervizorit nr. 657/SB/GJ-TE/PM/CP/cp, datë 12.12.2006, për periudhën korrik 2005 deri në mars 2006, ka pasur vonesa në zbatimin e procedurave. Vonesat zgjasin nga 9 në 112 ditë, ku p.sh. po të përmendim referencën e kontraktorit nr. 037a, datë 25.8.2005 “Për importimin instrumenteve të laboratorit, procedura është vonuar për 71 ditë.

Mbi shqetësimin e krijuar nga vonesat në lidhje me procedurat doganore në interes të projektit, PMU me shkresën nr. 4210, datë 21.12.2006, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me një listë të vonesave të shkaktuara Kontraktorit, për të cilin ai ka ngritur pretendime për kompensim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në lidhje me këtë problem, me shkresë nr. 15341, datë 19.01.2007, ka cilësuar se koha e nevojshme nga marrja e kërkesës është maksimumi 5 ditë, duke përjashtuar ditët e festave. Sa më sipër për vonesa në procedurat doganore, kontraktori ka ngritur pretendimin për shtyrje të afatit të punimeve me 57 ditë, si dhe kosto shtesë në vlerën 668 551.08 euro.

***Përsa i përket shpronësimeve***, vetëm për periudhën 01.05.2006 deri me 14.09.2006, kontraktori me shkresë nr. 1786/VP/sv/1066, datë 16.10.2006, ka ngritur pretendimin që shpronësimet kanë ndikuar ecurinë e punimeve duke shkaktuar vonesa dhe si dhe kosto shtesë. Për këtë arsye, nga ana e tij është kërkuar shtesë afati të përfundimit të punimeve prej 87 ditësh si dhe kosto shtesë me vlerë 1 444 387.69 euro.

***Përsa i përket kushteve të papërshtatshme të motit***, kontraktori ka ngritur pretendimin për shtyrje të afatit të punimeve me 46 ditë.

Në lidhje me pretendimet e mësipërme, bazuar në pikën 10 të raportit progresiv nr. 14, për muajin janar 2007, nga ana e supervizorit është cituar se, bazuar në termat e kontratës pretendimet e kontraktorit duhet të mos merren në konsideratë, por duhen sqaruar në detaje, pasi për një sërë prej tyre, si p.sh. për praktikat doganore, duken qartë vonesat e shkaktuara.

Një pretendim tjetër i kontraktorit është realizimi me vonesë i pagesave, në kundërshtim me kushtet e kontratës, kjo duke filluar që nga pagesa e paradhënies. Në bazë të pikës 43.3 dhe 50 të kushteve të përgjithshme të kontratës dhe pikës 43.3 të kushteve të veçanta të kontratës, parafinancimi duhet të realizohet brenda 45 ditëve nga data e marrjes së certifikatës së pagesës nga PMU (agjencia kontraktore), certifikatë kjo e lëshuar nga supervizori. Vlera e kësaj pagesë është 1 857 651.63 euro, që përfaqëson 10% të vlerës së kontratës. Nga kjo shumë, vlera prej 550 000 euro është realizuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë, ndërsa vlera prej 1 722 114.67 (1 857 651.63-550 000 + 414 561.84) është debituar me datë 08.12.2005, me datë vlefshmërie 06.12.2005. Afati i fundit për realizimin e kësaj pagese ishte data 29.08.2005. Vlera prej 414 561.84 euro përbën pagesën e paradhënies, si rezultat i financimit të opsionit 1 të kontratës. Në këto kushte, bazuar në pikën 50.2 të kushteve të përgjithshme të kontratës, në raste vonesash

të pagesave do të aplikohet interes prej 2% në ditën e parë të muajit në të cilin skadon afati plus 3.5% për ditë vonese. Sipas afateve të pagesave rezulton se pagesa e parafinancimit në vlerën 1 307 651.63 euro, është vonuar me 75 ditë. Ky interes është llogaritur si më poshtë:

$$\frac{2+3.5}{100} \times \frac{75}{365} \times 1\,307\,651.63 = 14\,778.25 \text{ euro.}$$

Kjo vlerë është aprovuar për dhënie në minutat e takimit të datës 11.12.2006. Për këtë, kontraktori ka kërkuar pagesën e këtij interesi si dhe shtyrje të afatit të punimeve, por shtyrja e afatit të punimeve si rezultat i vonesës së kësaj pagese, nuk është realizuar. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, miratimi është dhënë me shkresë nr. 9216, datë 20.12.2006. Kjo vlerë i është dhënë kontraktorit me pagesë nr. 11, datë 06.02.2007.

*Pagesa e interesit të paguar kontraktorit në vlerën 14 778.25 euro, ardhur si rezultat i mospagesës sipas kohës së vendosur në kontratë, nga ana e PMU përbën dëm ekonomik për të cilën mbajnë përgjegjësi personat përgjegjës.*

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, gjatë realizimit të kontratës janë bërë 4 ndryshime, nga të cilat vetëm urdhri i ndryshimit nr. 4 ka të bëjë me ndryshime në rritje të vlerës së kontratës.

Ky urdhër ka të bëjë me ndryshime përsa i përket seksionit të gërmimit të skarpateve, kryesisht nga km 11 + 140 deri në km 20 + 280. Krahas ndryshimit të pjerrësisë së këtyre skarpateve është vendosur që në krye të tyre të ndërtohen mure me gabione të mbushur me gurë. Prapa murit do të ndërtohet rrjet drenazhimi. Kostoja e këtyre punimeve është përcaktuar 547 461.12 euro.

Ky ndryshim krahasuar me kontratën bazë sipas zërave të punimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Përmbledhja e punimeve	Vlera sipas kontratës (euro)	Vlera sipas volumeve me shtesën nr. 4 (euro)	Vlera e rritur sipas zërit (euro)	Vlera e zbritur sipas zërit (euro)
1	Të përgjithshme	2 817 112.84	3 018 678.66	201 565.14	
2	Shkatërrime dhe pastrim territori	347 673.29	316 360.37		32 172.92
3	Punime gërmime	4 180 810.85	4 275 098.9	94 288.05	
4	Punime veshje	4 001 227.7	4 001 227.7		
5	Kanalizime, drenazhime dhe riparime të kanaleve të kullimit	4 733 048.95	4 806 461.29	15 024.28	
6	Studime për strukturat e themeleve	153 318.16	221 764.51	68 446.35	
7	Punime ndërtimi ura	1 339 605.47	2 085 458.87	60 659.75	
8.1	Mure mbajtëse betoni	480 267.36	346 085.79		44 935.79
8.2	Mure mbrojtës betoni	1 482 912.5	230 663.33		
9	Pajisje rrugorë	1 143 264.11	1 143 264.11		
10	Punime mbrojtje skarpate	1 126 704.4	1 273 680.47	146 976.07	
11	Zhvendosje/vendosje pajisjesh rrugore dhe punime ndriçimi rruge	292 998.92	330 609.12	37 610.2	
	<b>Totali (1-11)</b>	<b>22 098 944.55</b>	<b>22 646 405.67</b>	<b>624 569.84</b>	<b>77 108.71</b>
	<b>Vlera e urdhrit të ndryshimit nr.4</b>	<b>547 461.12</b>			

Krahasuar me punimet e përshkruara në kontratë, realizimi deri me datë 31.7.2007, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Përmbledhja e punimeve	Vlera sipas kontratës (euro)	Vlera sipas volumeve me shtesën nr.4 (euro)	Realizimi (euro)	Realizimi %
1	Të përgjithshme	2 817 112.84	3 018 678.66	2 488 872.3	82.45
2	Shkatërrime dhe pastrim territori	347 673.29	316 360.37	262 070.29	82.84
3	Punime gërmime	4 180 810.85	4 275 098.9	2 960 375.39	69.25
4	Punime veshje	4 001 227.7	4 001 227.7	1 490 530.18	37.25
5	Kanalizime, drenazhime dhe riparime të kanaleve të	4 733 048.95	4 806 461.29	2 847 607.84	59.25

	kullimit				
6	Studime për strukturat e themeleve	153 318.16	221 764.51	236 982.11	106.86
7	Punime ndërtimi ura	1 339 605.47	2 085 458.87	1 420 184.73	68.1
8.1	Mure mbajtëse betoni	480 267.36	346 085.79	332 591.55	96.1
8.2	Mure mbrojtës betoni	1 482 912.5	230 663.33	229 684.65	99.58
9	Pajisje rrugorë	1 143 264.11	1 143 264.11	85 966.33	7.52
10	Punime mbrojtje skarpate	1 126 704.4	1 273 680.47	266 646.47	20.92
11	Zhvendosje/vendosje pajisjesh rrugore dhe punime ndriçimi rruge	292 998.92	330 609.12	259 200.74	78.4
	<b>Totali (1-11)</b>	<b>23 424 881.22</b>	<b>22 049 353.13</b>	<b>12 880 712.58</b>	<b>58.42</b>
	Zbritja e ofruar në tender	-702 746.42	-702 746.42	-417 207.79	59.37
	<b>TOTALI</b>	<b>22 722 134</b>	<b>21 346 606.71</b>	<b>12 463 504.79</b>	<b>58.39</b>

*- Mbi shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve*

Me shkresë të Drejtorisë së Përgjithshëm të Rrugëve nr. 3912, datë 18.06.2007 është njoftuar Supervizori se, si pasojë e devijimeve të bëra në zonën e mbrojtur të “Ujit të Ftohtë Tepelenë”, bazuar edhe në kërkesën e kontraktorit është miratuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve deri me 30 shtator 2007.

Ndërsa me shkresë nr. 6984, datë 28.09.2007 është njoftuar supervizori se është miratuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve deri me datë 30 nëntor 2007.

Në minutat e takimit të datës 03.10.2007 është diskutuar për rekomandimin e zgjidhjes miqësore në lidhje me pretendimet e paraqitura nga kontraktori. Kjo zgjidhje konsiston në faktin e garantimit të periudhës së shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve si më poshtë:

**a-** Seksioni i rrugës nga km 0+00 deri në km 12+00 (53% e gjatësisë së rrugës sipas projektit) do të përfundohet deri me 15.10.2007.

**b-** Seksionet km 12+00 deri në 16+200, km 16+700 deri 17+250 dhe km 18+260 deri 22+500 do të përfundohet në fund të dhjetorit 2007 (40% e gjatësisë së rrugës sipas projektit).

**c-** Seksionet km 16+200 deri 16+700 (zona me tokë të rrëshqitshme) dhe km 17+ 275 deri km 18+260 (zona e mbrojtur) do të përfundohet me datë 15.04.2008 (gjatësia totale 1.5 km, që përfaqëson 7% të gjatësisë së rrugës së projektit).

Kjo zgjidhje miqësore do të garantojë kontraktorin për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, por pa kosto financimi shtesë apo kompensimi.

Bërja reale e kësaj zgjidhje miqësore nuk është realizuar akoma, pasi vendimi do të merret pas negociatave të domosdoshme me kontraktin.

Përsa i përket realizimit të punimeve në terren u zhvillua kontroll nga ku rezultoi se në përgjithësi punimet janë realizuar me cilësi të mirë dhe konform projektzbatimit. Ndërmjet Gjyroskastër dhe pikës së fillimit të projektit, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve është miratuar një fond për riparimin e rreth 1 km rrugë.

Për realizimin e këtyre punimeve janë kontraktuar 2 firma. Fillimi i punimeve është përcaktuar data 07.08.2007 dhe e përfundimit data 07.10.2008. Nga kontrolli në vend rezultoi se ka mbivendosje të punimeve të realizuara nga këto firma në projektin e rrugës Gjyroskastër-Tepelenë në një distancë 120 m. Punimet konsistojnë në mbushje me inerte për të rritur nivelin e rrugës si pasojë e përmbytjeve të ndodhura kohët e fundit. Si pasojë e këtyre punimeve është mbuluar një shtresë asfaltbetoni me trashësi 20 cm me një sipërfaqe 1260 m<sup>2</sup>.

Vlera e kësaj shtrese të bërë të papërdorshme është 13 821 euro si më poshtë:

Nr.	Trashësia	Sipërfaqe	Çmimi	Vlera Euro
1	40 mm	1260 m <sup>2</sup>	2.43 Euro/m <sup>2</sup>	3 061
2	60 mm	1260 m <sup>2</sup>	3.29 Euro/m <sup>2</sup>	4 145
3	100 mm	1260 m <sup>2</sup>	5.25 Euro/m <sup>2</sup>	6 615
<b>Shuma:</b>				<b>13 821</b>

Vlera e mësipërme prej 13 821 euro ka rritur shpenzimet për të njëjtin seksion rruge, veprim i cili ka ardhur si pasojë e mosparashikimit si dhe mos menaxhimit të mirë të punimeve të dy kontratave respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

*Mbi kontrollin e kryer për zbatimin e kontratës së konsulencës.*

Kontrata e konsulencës është nënshkruar me datë 12.11.2002, ndërmjet autoritetit kontraktor dhe konsulentit. Zbatimi i kontratës së konsulencës është përcaktuar për 4 faza:

Faza e parë, e dytë dhe e tretë me vlerë 724 244 euro.

Faza e katërt me vlerë 704 822 euro.

Fusha e zbatimit të konsulencës sipas fazave përshkruhet si më poshtë:

**Faza e parë**, rishikimi i vizatimeve, vizatimet përfundimtare të detajuara e dokumentet e tenderit për një periudhë 5 muaj.

**Faza e dytë**, paratenderimi dhe periudha e tenderimit për një periudhë 3 muaj.

**Faza e tretë**, vazhdimësia e vizatimeve përgjatë periudhës së ndërtimit.

**Faza e katërt**, administrimi i kontratës dhe supervizioni i punimeve për një periudhë 15 muaj.

Për fazën e katërt që ka të bëjë kryesisht me supervizionin e punimeve, sipas kontratës bazë janë ofruar çmimet për ditë pune si më poshtë:

Pagesat sipas stafit	Parashikimi i ditëve të punës	Çmimi për ditë pune (euro)	Vlera (euro)
<b>Ekspert ndërkombëtar me kohë të gjatë pune</b>			
Drejtues grupi	286	659	188 474
Ekspert me eksperiencë të madhe	484	659	318 956
Ekspert me eksperiencë të vogël	0	0	0
<b>Ekspertë lokalë me kohë të gjatë pune</b>			
Ekspert me eksperiencë të madhe	1584	87	137 808
Ekspert me eksperiencë të vogël	0	0	0
<b>Ekspert ndërkombëtar me kohë të shkurtë pune</b>			
Ekspert me eksperiencë të madhe	33	1048	35 584
Ekspert me eksperiencë mesatare	0	0	0
<b>Ekspertë lokalë me kohë të shkurtë pune</b>			
Ekspert me eksperiencë të madhe	0	120	0
Ekspert me eksperiencë të vogël	0	50	0
<b>Totali i pagesave</b>			<b>679 822</b>
rezervë			25 000
<b>Vlera e kontratës</b>			<b>704 822</b>

Deri në momentin e kontrollit, kontratës bazë i janë bërë dy shtesa, e më konkretisht:

**Shtesa e parë** është miratuar me datë 07.7.2005, ndërmjet konsulentit dhe agjencisë kontraktore. Kjo shtesë ka të bëjë me rishikimin e buxhetit sipas të cilës, për fazat 1, 2 e 3, vlera e kontratës bëhet 713 951 euro dhe për fazën 4 në maksimum në vlerën 785 985 euro.

Nga dokumentecioni i vënë në dispozicion, rezultojnë vetëm pagesat për fazën e katërt të kontratës së konsulencës së bashku me amendamentet.

Për fazën e katërt, së bashku me shtesën 1, konsulenti është likuiduar në vlerën 785 958 euro.

**Shtesa e dytë** e kontratës është miratuar me datë 18.04.2007, ndërmjet konsulentit dhe ish-drejtorit të Përgjithshëm të Rrugëve, me vlerë 838 800 euro. Sipas kësaj shtese, ka ndryshim të çmimit të pagesës për ditë pune, si më poshtë:

Pagesat	Parashikimi i ditëve të punës	Çmimi për ditë pune sipas shtesës nr. 2 të kontratës	Çmimi sipas kontratës bazë	Vlera sipas shtesës nr.2
<b>Ekspert ndërkombëtar me kohë të gjatë pune</b>				
Drejtues grupi	264	719	659	189 816
Ekspert me eksperiencë të madhe	528	719	659	379 632
Ekspert me eksperiencë të vogël	1584	95	-	150 480
<b>Ekspert ndërkombëtar me kohë të shkurtë pune</b>				
Menaxher projekti	60	1143		68 580
Ekspert për "claims"	44	1143		50 292
<b>Maksimumi i vlerës së kontratës</b>				<b>838 800</b>

Vlera e kontratës së konsulencës pas këtyre shtesave paraqitet, si më poshtë:

Kontrata e konsulencës	Vlera për fazën 1,2,3 (euro)	Vlera për fazën 4 (euro)
Kontrata bazë	724 244	704 822
Shtesa nr.1 (rishikim)	713 951	7785 985
Shtesa nr.2	96 703	838 800
Shuma sipas fazave	810 654	1 624 785
<b>TOTALI</b>	<b>2 435 439 Euro.</b>	

Pagesat për konsulentin sipas shtesës nr. 2 të kontratës janë realizua, si më poshtë:

Përshkrimi	Çmimi sipas shtesës së kontratës (euro)	Çmimi sipas shtesës së kontratës (euro)	Ditë pune	Paguar (euro)	Pagesa në kundërshtim me kontratën bazë (euro)
Lider grupi	719	659	79	56 801	4 740
Ekspert me eksperiencë	719	659	130	93 470	7 800
Menaxher projekti	1143	-	14	16 002	-
Ekspert "claims"	1143	-	37	42 291	-
Ekspert lokal me kohë të gjatë pune	95	87	382	36 290	3 056
<b>paguar</b>				<b>244 854</b>	<b>15 596</b>

Në këtë shtesë vërehet ndryshimi i pagesës së stafit të konsulentit, referuar çmimeve të paraqitura në tender dhe të kontraktuara. Ndryshimi i çmimit për ditë pune me tendencë rritjen e tyre bie në kundërshtim me pikat e mëposhtme të kontratës bazë:

**Në bazë të artikullit 1, pika 1.1** të kontratës, kjo kontratë është bazuar në pagesa, në të cilën shërbimet e zbatuara do të bazohen në çmime fikse të pandryshuara. [Fee based contract: a contract under which the services are provided on the bases of fixed fee rates].

**Në bazë të artikullit 21.1 të kontratës** “Mbi shtesat e kontratës” theksohet se: Nëse do të bëhet ndonjë shtesë e kontratës, do të konkludohet me të njëjtat terma si të kontratës bazë. [Amendment of contract: Any amendment of the contract must be set out in writing in an addendum, to be concluded on the same terms as the original contract...]

Sa më sipër, vlera prej 15 596 euro, paguar konsulentit deri në momentin e kontrollit, përbën dëm ekonomik, pasi është bërë në kundërshtim me kushtet kryesore të kontratës bazë. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga konsulenti.

Për këtë veprim përgjegjësi mban ish-drejtori i përgjithshëm i Rrugëve dhe drejtori i PIT.

Përsa më lart është mbajtur procesverbali nr. 3, datë 05.11.2007

*Mbi dokumentet shoqëruese të kërkesës për shpronësim dhe njoftimi për shpronësim publik, mbi kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, mbi aktmarrëveshjet si titull ekzekutiv, respektimi i afatit të lidhjes së tyre si dhe dokumentecioni i nevojshëm shoqërues, mbi dokumentet që vërtetojnë vlerën e shpenzimeve procedurale të shpronësimit*

*Mbi shpronësimet e kryera për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Gjirokastër-Tepelenë.*

Nga kontrolli rezultoi:

1. Në zbatim të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, neni 11, nga ana e DPRR-së i është dërguar Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacioneve kërkesa për shpronësim.

- Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacioneve me shkresën nr. 550, datë 25.10.2003, i dërgon DPRR-së miratimin mbi pranimin e kërkesës “Për shpronësim për interes publik të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Gjirokastër-Tepelenë”.

- Mbi bazën e shkresës së mësipërme, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të pranimit, është lidhur aktmarrëveshja midis Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacioneve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

- Me vendimin nr. 1, datë 21.01.2004, Këshilli Teknik i DPRR-së ka miratuar “Draftin e projektit të detajuar të rrugës Gjirokastër-Tepelenë”, të hartuar nga firma konsulente e huaj.

- Këshilli i Rregullimit të Territorit të Qarkut Gjirokastër, me vendimin nr. 41, datë 14.7.2004, ka miratuar lejen e ndërtimit për objektin “Ndërtim rruge nacionale, segmenti Gjirokastër-Tepelenë korridori veri-jug”.

Në kërkesën për shpronësim të bërë nga DPRR me nr. 5753, datë 27.9.2004, janë pasqyruar dhe është kërkuar shpronësim për të gjitha rastet që pronarët e pashpronësuar kanë paraqitur dokumente ligjore të lëshuar nga ZVRPP ose janë në procesin e regjistrimit pasi kanë marrë dokumentecionin përkatës nga KKKP.

Shpronësimi bazë është bërë me VKM nr. 877, datë 22.12.2004 “Mbi shpronësimet e kryera për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Gjirokastër-Tepelenë”.

Kontrolli i shpronësimeve të miratuara me vendimin e mësipërm është kryer me programin e kontrollit të KLSH-së nr. 914/1, datë 11.12.2006.

*Kërkesa për shpronësimin shtesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve është bërë për këto arsye:*

a. Shpronësimi i pronave për të cilat në momentin e shpronësimit në ZRPP Gjirokastër rezultoi “shtet” për arsye se nuk ishin regjistruar në pronësi të pronarëve përkatës.

b. Shpronësimi nga saktësimi i sipërfaqes që kërkohet për ndërtimin e kanaleve kullues-vaditës.

c. Shpronësimi i cili ka ardhur nga saktësimi i sipërfaqes së prekur.

*Lista e personave që shpronësohen nga ndërtimi i segmentit rrugor Gjirokastër-Tepelenë përbëhet nga disa kolona analiza e të cilave pasqyrohet sipas pasqyrës bashkëlidhur.*

Në pasqyrë sqarohet:

a. Për sipërfaqet e cenuara nga ndërtimi i rrugës Gjirokastër-Tepelenë dhe nuk janë kryer shpronësime (për mungesë dokumentecioni), kolona “sipërfaqja e shpronësuar sipas VKM nr. 877, datë 22.12.2004 rezultoi me vlerën zero”. Ndërsa, në kolonën tjetër sipërfaqja për shpronësim në pasqyrë është vënë shënimi “proces regjistrimi”.

b. Për të gjithë personat që shpronësimi sipas pikës 2 dhe 3 në tabelë është bërë plotësimi i saj, duke përcaktuar: sipërfaqen totale për shpronësim, sipërfaqja e shpronësuar me VKM nr. 877, datë 22.12.2004 dhe sipërfaqja shtesë që duhet shpronësuar.

Ky shpronësim shtesë është propozuar mbas saktësimit të vendosjes së kanalit vaditës që dëmtohej nga punimet, si dhe të kanaleve të drenazimit të rrugës të cilët në projektin e paraqitur kanë qenë të pasqyruara në profilin tip dhe të pavendosura, në asnjë rast, në profil tërthor, me të cilët janë bërë shpronësimet me vendimin e mësipërm.

c. Për rastet kur mungojnë dokumentet e pronësisë në pasqyrën përkatëse, është vënë shënimi “plotësim me dokumente”.

*Spontimi dhe ballafaqimi i listës së shpronësimeve.*

Në listat përfundimtare, ashtu sikurse sqarohet edhe në pasqyrë përveç kolonës 3, ku përcaktohet sipërfaqja që kërkohet të shpronësohet, ka dhe dy kolona të tjera në të cilat përcaktohet sipërfaqja totale e shpronësimit (kolona nr. 1) dhe ajo e shpronësuar me VKM nr. 877, datë 22.12.2004 (kolona nr. 2).

Nga kontrolli, spontimi dhe ballafaqimi i listës së shpronësimeve nr. 2 me listën e shpronësimeve të kryera, sipas VKM nr. 877, datë 22.12.2004 dhe me gjithë dokumentecionin përkatës rezultoi se:

a. Në 11 raste, në kërkesën e dytë ka mos përputhje lidhur me emrat e pronarëve, ku për të njëjtën pasuri dhe sipërfaqe, paraqiten me emra të ndryshëm.

b. Në 2 raste, për të njëjtët pronarë dhe sipërfaqe të njëjta rezultojnë numra të tjerë pasurie.

c. Në 2 raste, nuk ka përputhje për numrin e pasurive të pronave ndërmjet sipërfaqes totale që duhej shpronësuar, me sipërfaqen e shpronësuar me vendimin e mësipërm dhe sipërfaqen shtesë të kërkuar për shpronësim.

ç. Në 6 raste për sipërfaqet e shpronësimeve shtesë, mungon certifikata e pronësisë së bashku me hartën treguese të pasurisë.

d. Në 141 raste, në dosjet përkatëse, dokumentecioni nuk është i plotë dhe konkretisht në dosjet e pasurive sipas fshatrave.

e. Në 2 raste, sipërfaqet përkatëse të tokave rezultojnë me pretendim pronësie (mbivendosje).

f. Në 8 raste, pronësia e konfirmuar si shtet nga ZRPP Gjirokastër janë përfshirë në listën përfundimtare si të paidentifikuar. Për këto pasuri, nga ana e Sektorit të Shpronësimeve nuk është kërkuar përsëri konfirmim nga ZRPP Gjirokastër.

g. Nga kontrolli rezultoi se në 2 raste, pronësia regjistruar “truall” duhet “arë”.

*Kontroll në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”*

Neni 31, i ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 përcakton shprehimisht: “Në zbatim të studimeve urbanistike të të gjitha llojeve, sipas fazave të realizimit të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera nënligjore, bëhet shpronësimi në përputhje të plotë me studimin, me vlerësimin e pasurive të paluajtshme pronë private dhe me procedurat përkatëse për shpronësim”. Pika 46/i, e VKM nr. 722, datë 19.11.1998 përcakton shprehimisht: “Studimi urbanistik pjesor (SUP) tregon kufijtë e zonës së përfshirë prej tij dhe përmban: germa i, listat sipas zërave kadastror të pronarëve për t’u shpronësuar ose do t’iu vihen kushtëzime të caktuara”.

Nga kontrolli në lidhje me saktësinë e sipërfaqeve të shpronësuarra dhe të miratuara me VKM nr. 877, datë 22.12.2004, si dhe për sipërfaqet që propozohen me listën rezultoi se:

Është zbatuar ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 dhe VKM nr. 722, datë 19.11.1998, për arsye se në detyrën e projektimit është zbatuar projekti i zbatimit të planimetrisë së shpronësimeve.

Në planimetrinë e ndërtimit të rrugës Gjirokastër-Tepelenë sipas draftit të dërguar nga firma konsulente e huaj “SAUTI” dhe të miratuar me vendimin nr. 1, datë 21.01.2004, nga Këshilli Teknik i DPRR-së si dhe në projektin shtesë të hartuar nga kjo firmë dhe të miratuar në Këshillin Teknik të kësaj drejtorie, rezultoi se në këto projekte të hartuara sipas plansheteve dhe zonave kadastrale përkatëse janë përcaktuar saktësisht sipërfaqet e pronave (sipas plansheteve, zonave kadastrale dhe HTR-ve të lëshuara nga ZVRPP Gjirokastër dhe Tepelenë), që preken nga ndërtimi i kësaj rruge dhe të përcaktuara realisht në listat përkatëse të shpronësimit shtesë.

*Kontroll mbi zbatimin e VKM nr. 138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”*

Nga kontrolli rezultoi:

**A. Në lidhje me kontrollin e pasurive arë, pemëtore, vreshtari etj.**

- DPRR me shkresën nr. 5166, datë 25.07.2006 i dërgon ZRPP Gjirokastër kërkesë për konfirmim për pronësinë e pasurive të paluajtshme si dhe deklarimin mbi çmimin mesatar të shitblerjes së tyre.

- Në përgjigje të shkresës së mësipërme, ZRPP Gjirokastër, me shkresën nr. 245, datë 02.8.2006 i dërgon konfirmimin përkatës si dhe çmimin e shit-blerjes së kontratave të shitjes, për tremujorin e fundit për zonën Mashkullorë-Shtepëz, në të cilën rezultoi 250 lekë/m<sup>2</sup> për pasurinë “arë” dhe 730 lekë për pasurinë “vresht”.

- DPRR me shkresën nr. 5383, datë 03.8.2006 i drejtohet Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me të cilën kërkon në zbatim të VKM nr. 138, datë 23.03.2000 për të dërguar çmimet e dru frutorëve.

Nisur nga fakti se për këtë segment rrugor është bërë një shpronësim dhe për një pjesë rezulton shpronësim për diferencë sipërfaqe është dhënë mendimi, dhe në tabelë është vendosur si vlerë për pasurinë “arë”, “kullotë” dhe “truall”, vlera sipas listës dhe llojit të pasurive të përcaktuara sipas VKM nr. 877, ndërsa për llojin vresht është vendosur vlera e dërguar nga ZRPP.

Për sa më sipër rezulton se nga ana e Sektorit të Shpronësimeve në listën shtesë të shpronësimeve është propozuar vlera e tokës arë 600 lekë/m<sup>2</sup>, sipas çmimit të vendosur dhe miratuar në listën e parë të shpronësimeve me VKM nr. 877, datë 22.12.2004, kur sipas VKM nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes të masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik”, pika 5, e cila përcakton shprehimisht: “Vlerësimi për tokën bujqësore, bimëve, dru frutorëve, pyjeve, kullotave, livadheve, tokave pyjore dhe fidanishteve të përhershme të përcaktohet si mesatare e shitblerjeve që ka ZRPP-ja, në përputhje me procedurën për rastin e truallit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi”, pra me 250 lekë m<sup>2</sup>.

Nisur nga problemet e trajtuara më sipër në drejtim të problemeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimit të mësipërm, nga ana e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit me shkresën nr. 7479, datë 08.10.2007 “Projektvendim për mendim”, ju është dërguar për mendim ministrive përkatëse së bashku me “Projektvendimin për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.

Në këtë projektvendim propozohet që vlerësimi për truallin, tokën bujqësore, tokën pyjore, kullotat livadhet të përcaktohen sipas çmimeve të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave në zbatim të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar.

**B. Në lidhje me vlerësimin e pasurive të paluajtshme si: objekte industriale, bujqësore, pika karburanti etj.**

Nga kontrolli rezultoi:

**a.** Zona kadastrale 2956, nr. pasurie 648/8 dhe 648/12, regjistruar në pronësi të një personi pikë karburanti me sipërfaqe ndërtimore 275 m<sup>2</sup> dhe truall 550 m<sup>2</sup>, e cila preket nga ndërtimi i rrugës.

Në dosje mungon preventivi përkatës si dhe praktika shkresore përkatëse për vlerësimin e pasurisë, në zbatim kjo të VKM nr. 138, datë 23.02.2000, ndërsa nga Sektori i Shpronësimeve në Komisionin e Posaçëm të Shpronësimeve në MPBTT, për këtë objekt është dërguar vlera prej 2 986 560 lekë.

**b.** Zona kadastrale 2609, nr. pasurie 285/6, regjistruar pikë karburanti me sipërfaqe ndërtimore 200 m<sup>2</sup> dhe truall 1900 m<sup>2</sup>, në pronësi të një personi.

Në dosje mungon vlerësimi dhe praktika shkresore sipas VKM nr. 877, datë 22.12.2004, kur sipas VKM nr. 138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes të masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik”, pika 5, ndërsa nga Sektori i Shpronësimeve në komisionin e posaçëm të shpronësimeve në MPBTT, për këtë objekt është dërguar vlera prej 1 301 800 lekë.

c. Zona kadastrale 1961, nr. pasurie 55/2, regjistruar 680 m<sup>2</sup> truall në pronësi të një personi, kur në kërkesën e tij për shpronësim datë 20.01.2006 është për bar-restorant dhe truall, ndërsa në certifikatën e pronësisë të lëshuar po me këtë datë nga ZRPP Tepelenë, rezulton vetëm 680 m<sup>2</sup> truall.

Leja e ndërtimit për bar-restorant është miratuar me vendimin e KRRT-së të rrethit Tepelenë me nr. 40, datë 14.11.1994, por ky objekt nuk është regjistruar në ZRPP.

Në dosje rezulton edhe vlerësimi i këtij objekti për vlerën 2 146 220 lekë, sipas situacionit të punimeve të bërë nga investitori dhe sipërmarrësi, kur ky vlerësim duhet të ishte kryer nga ministria përkatëse, në zbatim të VKM nr. 138, datë 23.03.2000, pika 3, sipas së cilës:

“Vlerësimi për objektet e ndërtimit industriale bujqësore etj., përcaktohet me koston e ndërtimit nga ministritë përkatëse dhe konkretisht: çmimet të merren si mesatare e tregut, vlerësimi t’i zbritet amortizimi”.

Nga Sektori i Shpronësimeve në komisionin e posaçëm të shpronësimeve në MPBTT, për këtë objekt është dërguar vlera e mësipërme.

ç. Zona kadastrale 2609, nr. pasurie 284/13, regjistruar 300 m<sup>2</sup> truall, në pronësi të një personi.

Me vendimin nr. 30, datë 06.05.2004 të KRRT-së të Qarkut Gjirokastrë është miratuar rrethim sheshi, por muri rrethues nuk është regjistruar në ZRPP.

Në dosje rezulton preventivi i punimeve datë 06.05.2004, për shumën 528 682 lekë, përgatitur nga preventivuesi dhe nga Sektori i Shpronësimeve në komisionin e posaçëm të shpronësimeve në MPBTT, për murin rrethues është dërguar vlera e mësipërme.

*Për problemet e trajtuara më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish-specialisti në Sektorin e Shpronësimeve.*

#### *Kontroll mbi shpronësimin në zonën e “Ujit të Ftohtë” Tepelenë.*

Nga kontrolli rezultoi:

a. Drejtoria e Projekteve të Huaja (PIT) me shkresën nr. 5217, datë 30.07.2007 i drejtohet drejtorit të përgjithshëm të Rrugëve për problemin e zhvendosjes së linjës së furnizimit me ujë të Fabrikës së “Ujit të Ftohtë” Tepelenë.

Në shkresë përcaktohet shprehimisht:

*“Zona me të cilën do të kryhen punimet për zhvendosjen e linjës së furnizimit me ujë të Fabrikës së “Ujit të Ftohtë”, Tepelenë ndodhet jashtë kufirit të shpronësuar nga DPRR-ja”.*

b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tepelenë me vendimin e saj nr. 18 aktit, data e regjistrimit 01.08.2007 dhe nr. 18 vendimit, datë 03.08.2007, ka vendosur: Marrjen e masës provizore për sigurimin e padisë, duke urdhëruar palën e tretë, shoqërinë sh.a., të pezullojë punimet në aksin rrugor Uji i Ftohtë Tepelenë-Stabiliment.

c. Nga kontrolli rezultoi se mungonte dokumentacioni ligjor i mëposhtëm:

- Projekti ekzistues i linjës së ujit së bashku me miratimin nga KRRT e Bashkisë Tepelenë ose KRRT e Qarkut Gjirokastrë.

- Leja e ndërtimit të linjës së ujit nga burimi në stabiliment.

- Planimetria e sheshit të ndërtimit për linjën e ujit nga burimi në stabiliment.

- Leja e DPRR-së për lejimin e ndërtimit të linjës së ujit paralel me bordurën e rrugës.

*Kontroll mbi zbatimin e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.*

Sipas nenit 25 “Regjistrimi i ri i pasurive të shpronësuara” të ligjit të lartpërmendur, i cili përcakton se: “Në rastet kur pasuritë pronë private të shpronësuara duhet të regjistrohen sipas ligjit, ky regjistrim duhet të kryhet nga ministri kompetent, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Ministrave”, është nxjerrë urdhri me nr. extra, datë 26.7.2002 “Për ecurinë e punës në shpronësimet dhe regjistrimet e tyre pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme” nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit me nr. 2624 dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me nr. 475.

Nga kontrolli rezultoi se ligji dhe urdhri i mësipërm nuk janë zbatuar për arsye se nuk ka përfunduar procesi përfundimtar i shpronësimeve.

*Mbi kontrollin për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit për shpronësimet dhe detyrat e sekretarisë teknike, e ngritur pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit si edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve*

*Mbi ecurinë e dokumentacionit ose zbatimin i afatit kohor të shpronësimeve.*

DPRR me shkresën nr. 3450, datë 30.5.2006 “Kërkesë për konfirmim”, drejtuar ZRPP Gjirokastër, me të cilën kërkohet konfirmim për pronësinë e 38 pronarëve si dhe çmimin mesatar të shit-blerjeve sipas llojit të pasurive.

- Në përgjigje të shkresës së mësipërme, ZRPP Gjirokastër me shkresën nr. 193, datë 15.06.2006 dërgon konfirmimin përkatës.

- DPR me shkresën nr. 3452, datë 30.05.2006 “Kërkesë për konfirmim” i drejtohet ZRPP Tepelenë për konfirmimin e pronësisë për 9 pronarë, si dhe çmimin mesatar të shit-blerjeve sipas llojit të pasurive.

- DPRR me shkresën nr. 3824, datë 12.06.2006 “Kërkesë për konfirmim” i drejtohet ZRPP Gjirokastër për konfirmim pasurie.

- DPRR me shkresën nr. 4200, datë 06.06.2006 “Kërkesë për projekt” i drejtohet Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për projektin e plotë të zbatimit të tij, si rezultat i mospasqyrimin në projektin e parë të kanalit vaditës.

- Në përgjigje të shkresës së mësipërme, MPPTT me shkresën nr. 4159, datë 06.07.2006 dërgon letrën e supervizorit të punimeve si dhe një kopje në versionin elektronik të planimetrisë së kanalit vaditës.

- DPRR me shkresën nr. 5823, datë 22.08.2006 i drejtohet ZRPP Tepelenë me të cilën kërkon titullin e pronësive për pronarët, sipas listës përkatëse, si dhe çmimet e shitblerjeve sipas llojit të pasurive.

- DPRR me shkresën nr. 6148, datë 31.08.2006 i drejtohet ZRPP Gjirokastër me të cilën kërkon titullin e pronësisë sipas listës përkatëse, si dhe çmimet e shitblerjeve sipas llojit të pasurive.

- Në përgjigje të shkresës së mësipërme, ZRPP Gjirokastër me shkresën nr. 316, datë 12.10.2006 i dërgon DPRR listën e personave me konfirmim sipas titullit të pasurive si dhe sqarimet përkatëse.

- DPRR me shkresën nr. 6030/1, datë 04.09.2006 i dërgon Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për të dërguar çmimin për dru frutorët.

- Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i kthen përgjigje DPRR me të cilën ka dërguar

formularët me të dhënat përkatëse të plotësuar nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit, Gjirokastrë.

- DPRR me shkresën nr. 5823/1, datë 1.10.2006 i drejtohet ZRPP Gjirokastrë, për konfirmim për titullin e pronësisë sipas listës përkatëse, si dhe çmimet e shitblerjeve të pasurive.

- DPRR më shkresën nr. 6148/1, datë 11.10.2006 i drejtohet ZRPP Gjirokastrë për të konfirmuar titullin e pronësisë për pronarët sipas listës përkatëse si dhe çmimet e shitblerjeve për tre muajt e fundit sipas llojit të pasurisë.

- DPRR me shkresën nr. extra, datë 17.11.2006 “Argumenti juridik për shpronësimet në rehabilitimin e segmentit rrugor “Gjirokastrë-Tepelenë” i dërgon Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit shkaqet e vonesave për shpronësimet në këtë segment rrugor, së bashku me relacionin përkatës.

- DPRR me shkresën nr. 8187, datë 17.11.2006 i dërgon MPPTT “Kërkesën për shpronësim”.

- DPRR me shkresën nr. 8188, datë 17.11.2006, në vijim të shkresës nr. 5823, datë 22.08.2006 dhe nr. 5823/1, datë 11.10.2006, i drejtohet ZRPP Tepelenë për konfirmim për titullin e pronësisë si dhe çmimet e shitblerjeve për tre muajt e fundit.

- MPPTT me shkresën nr. 1446, datë 28.01.2007 “Mbi kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, të cilat preken nga ndërtimi dhe rehabilitimi i segmentit rrugor Gjirokastrë-Tepelenë”, për të sqaruar problemet sipas shkresës bashkëlidhur.

- MPPTT me shkresën nr. 5527, datë 16.7.2007 “Kërkohet të veprohet për plotësimin e praktikave të shpronësimeve”, me të cilën edhe një herë tërheq vëmendjen në drejtim të mungesës së korrektesisë në lidhje me shkresën nr. 1446, datë 28.01.2007, në të cilën janë trajtuar disa probleme dhe mangësi të konstatuara nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues dhe për këtë arsye të ndiqen problematikat e trajtuara në këtë shkresë dhe të bëhen sa më shpejtë plotësimet përkatëse, për të proceduar më tej në shpronësimin e pasurive të prekura nga ndërtimi i kësaj rruge.

Nga kontrolli rezultoi se deri në përfundim të procesit kontrollues të kryer nga ana e jonë, nga DPRR nuk i është kthyer përgjigje shkresës së mësipërme.

Për sa më sipër për moszbatim të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, VKM nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, si dhe ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative” ngarkohen me përgjegjësi:

- Ish-specialisti në Sektorin e Shpronësimeve për segmentin rrugor Gjirokastrë-Tepelenë, i cili deri më datën 12.04.2007, datë në të cilën është larguar, nuk ka kthyer përgjigje.

Po kështu problemet e trajtuara më sipër nuk janë ndjekur edhe nga ish-përgjegjësi i Sektorit të Shpronësimeve, për arsye se më datën 31.05.2007 është larguar nga puna.

Për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit u rekomanduan masa organizative, si dhe masa zhdëmtimi për dëmin ekonomik që kanë shkaktuar personat përgjegjës.

## 2. KONTROLL NË SUBJEKTIN DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE, NJËSIA E MENAXHIMIT TË PROJEKTIT “NDËRTIMI DHE SUPERVIZIONI SEGMENTIT RRUGOR LUSHNJË, FIER”

Në zbatim të programit të kontrollit, nga data 10.09.2007, deri më datën 31.10.2007, u ushtrua kontroll në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, Njësia e Menaxhimit të Projektit “Ndërtimi dhe supervizioni i segmentit rrugor Lushnjë-Fier” me objekt: “Mbi kontrollin e veprimtarisë ekonomiko-financiare, ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare dhe vlerësimi i zbatimit të projektit”.

Nga kontrolli i ushtruar rezultoi:

### *Mbi marrëveshjet me huadhënësin, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit*

1. *Projekti “Ndërtimi i rrugës Lushnjë-Fier, supervizioni i punimeve për dy segmentet vijues Lushnjë -Fier dhe Fier-Vlorë”.*

Në protokollin e bashkëpunimit për tre vitet 2002-2004. Qeveria e Republikës Italiane, nëpërmjet Kooperacionit Italian ka konfirmuar angazhimin për të financuar një ndërhyrje në sektorin rrugor të përbërë nga:

- Ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë–Fier;
- Supervizioni i punimeve në dy segmente vijues Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë.

Në bazë të protokollit të mësipërm dhe marrëveshjes së 25.02.2004, marrëveshje programi që ka të bëjë me realizimin e programit të ndërtimit të segmentit dhe supervizionin e tij. Qeveria e Republikës së Italisë me dekretin nr. 5387, të datës 01.6.2004, ka autorizuar MCC-në për t’i dhënë Shqipërisë një kredi financiare prej 24.350.000 euro, sipas kushteve të mëposhtme;

- Shlyerja në 42 këste të barabarta të njëpasnjëshme, çdo 6 muaj ku kësti i parë kthehet në detyrim për t’u paguar 17 vjet, pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje financiare.

- Norma e interesit nominal vjetor 0,10%, e pagueshme çdo gjashtëmuajor duke filluar nga çdo përdorim i shumës.

Gjatë kohës së zbatimit të kësaj marrëveshje nuk ka pasur ndryshime të marrëveshjes, ndryshime në shtesa ose pakësim të fondit të financimit.

### *Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjen e huadhënësin*

Objektivi kryesor i kësaj marrëveshje i cili është i përshkruar hollësisht në Programin e miratuar më 25 shkurt 2004 i cili propozon të përmirësojë gjendjen rrugore të rrugës Lushnjë-Fier-Vlorë, sipas kritereve të projektimit, në përputhje me standardet evropiane duke favorizuar lëvizjen e njerëzve dhe mallrave si brenda vendit, ashtu dhe me vendet kufitare, në koherencë me prioritetet rajonale, të cilat konsiderojnë rrugën Lushnjë-Fier-Vlorë pjesë përbërëse të Korridorit të VIII Pan-Evropian, te i cili segmenti Lushnjë-Fier-Vlorë përfaqëson shtojcën drejt jugut të vendit.

Objektivat e veçanta synojnë:

- Të përmirësojë gjendjen r rrugës Lushnjë-Fier-Vlorë sipas kritereve të projektimit në përputhje me standardet evropiane.

- Të përshtatin rrugën Lushnjë-Fier-Vlorë me nevojat e fluksit të trafikut të tanishëm dhe të ardhshëm dhe me nivele të larta sigurie.

- Të zvogëlojnë kohën e përshkrimit dhe të ulin kostot operative të mjeteve.

- Të favorizojnë zhvillimin ekonomik të Jugut të Shqipërisë.

Me mbarimin e punimeve në rrugë dhe vënien në efikasitet të aksit rrugor, arritja e objektivave të parashikuara më sipër do të jetë objekt vlerësimi i mëvonshëm, pasi në kohën që u krye kontrolli, rruga vazhdon të jetë në proces punimi.

***Mbi manaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar***

Menaxhimi nga PIU i projektit “Ndërtimi i rrugës Lushnjë-Fier, supervizioni i punimeve për dy segmentet vijues Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë”, është i rregulluar sipas marrëveshjes datë 28.1.2004 midis Ambasadës Italiane dhe Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacionit.

Në marrëveshjen e datës 28.01.2004, është përcaktuar se projekti, do të zbatohet nga njësia e koordinimit të projektit (PIU), nën autoritetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Struktura e PIU ka pasur në përbërjen e saj 5 persona dhe konkretisht drejtori i Njesisë së Zbatimit të Projektit, inxhinieri, financierja e projektit, asistenti/përkthyesi dhe shoferi i PIU.

Marrëdhëniet e punës të personelit të PIU janë rregulluar si më poshtë: drejtori dhe inxhinieri i PIU-t janë punonjës të DPRR, financierja e projektit, asistenti/përkthyesi dhe shoferi i PIU janë të kontraktuar nga Ambasada Italiane. Kontratat e punës nuk na u vunë në dispozicion nga personat e mësipërm.

***A. Nga kontrolli i pagesave të bëra për ndërtimin e segmentit rrugor kompanisë Maltauro nga PIU rezultoi se:***

Me certifikatën e pagesës nr. 3, datë 17.10.2006 ka likuiduar shumën 1.667.648.48 euro, shumë që i përket periudhës korrik-gusht 2006, në të cilën janë tërhequr më tepër për 43.120 euro.

Në certifikatën pasardhëse të pagesës me nr. 4, datë 11.01.2007, janë bërë pagesa për punimet e kryera në periudhën shtator-tetor në vlerë 941.929 euro, në të cilën janë tërhequr më shumë 43.170 euro, dhe në certifikatën nr. 5, për punimet e kryera për periudhën nëntor-dhjetor 2006 është zbritur shuma 43.069 euro e certifikatës paraardhëse, në vend që të zbritet shuma 86.290 euro, duke mbetur një diferencë prej 43.221 euro paguar më shumë.

Kjo diferencë e likuiduar më tepër nga PIU ka mbetur në llogarinë e firmës në të cilën nuk është bërë korigjimi.

Në marrëveshjen e datës 28.01.2004, midis MTT përfaqësuar nga DPRR-ja dhe drejtori i Zyrës për Bashkëpunim në Ambasadën Italiane, në pikën 5 të saj përcaktohet se për mbështetje teknike të PIU-t vihet në dispozicion nga pala italiane fondi prej 300.000 euro, në formë grandi, për sistemimin, mobilimin, për llogari rrjedhëse si dhe pagesat e stafit.

Ky fond nuk u kontrollua nga grupi i kontrollit, pasi administrohej totalisht nga Kooperacioni Italian.

Nga ana e Degës së Financës së DPRR-së është mbajtur çdo vit aktrakordimi me Degën e Thesarit, për rakordimin e shpenzimeve për t.v.sh.-në dhe taksën doganore. Deri tani nga shuma 4.9 milionë euro e akorduar nga qeveria shqiptare për pagesën e taksave doganore dhe t.v.sh. janë shpenzuar 2.329,375 leke.

Gjatë vitit 2005-2006-2007 janë raportuar sistematikisht në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Punëve Publike disbursimet dhe shpenzimet mujore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore, mbështetur në udhëzimin nr. 8, datë 17.02.2003, të Ministrisë së Financave dhe pikës 17, të VKM nr. 116, datë 24.02.1997 “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Republikës së Shqipërisë”.

PIU ka mbajtur në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me standardet e kontabilitetit të gjitha llogaritë e projektit. Nga kontrolli i ditarit të bankës rezulton se veprimet janë të regjistruara në mënyrë kronologjike, si dhe kanë të bashkëngjitur dokumentacionin justifikues.

### **Shkalla e realizimit të disbursimeve**

Sipas nenit 4 të Marrëveshjes së Huasë, termat e përdorimit të Kredisë Financiare, periudha e disbursimit të Kredisë Financiare është përcaktuar 36 muaj duke u nisur nga data e e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje.

Për projektin “Ndërtimi dhe supervizioni i segmentit rrugor Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë” është nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe perfaqesuesve italiane, marrëveshja financiare për përdorimin e financimit prej 24 350 000 euro si kredi ndihme, e konkretisht kjo shumë përfshin në vetvete:

1. Financimin në shumën 22 300 000 euro për ndërtimin dhe mbikëqyrjen e punimeve të segmentit Lushnjë-Fier.

2. Financimin në shumën 2.050 milionë euro për supervizionin e segmenteve vijues Fier-Levan dhe Levan-Vlorë.

Marrëveshjet financiare janë bërë efektive më datë 25.02.2004, me nënshkrimin e marrëveshjes së zbatimit të programit për arritjen e objektit të mësipërm.

Nga kontrolli i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me disbursimin dhe shpenzimin e fondeve rezultoi se:

Nga shuma totale e kredisë prej 24 350 000 euro është disbursuar deri më 01.11.2007, shuma 9 214 898 euro ose 37.55%, sipas tabelës së mëposhtme:

Projekti	Vlera e kontratës	Supervizioni	Totali	Shuma e disbursuar		Realiz. financ% kundrejt kontratës	Realiz. Financiar në % kundrejt kredisë 24.350 000
				ndërtim	superviz		
Lushnje-Fier	17 545 255	693 000	18 238 255	8 689 255	455 174	50.14%	37.55%
Fier-Levan	0	0	0	0		0.00	0.00%
Levan -Vlorë		703,700	703,700			10.00%	0.29%

Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme rezulton se nga kontrata e punimeve e cila është në vlerën 17 545 255.32 euro me kompaninë private janë kryer punime dhe janë paguar në vlerën 8 689 353.72 euro, pra shprehur në përqindje rreth 49% të vlerës totale të kontratës. Ndërsa, supervizioni i cili kryhet nga firma tjetër me vlerë të kontratës 693 000 euro është paguar për periudhën 10.01.2005 deri 01.11.2007, në shumën 455 174.74 euro, pra shprehur në përqindje rreth 65% të vlerës së kontratës. Duke i llogaritur në total (dy kontratat së bashku), disbursimi për këtë segment është në nivelin 50.14%, në total e gjithë kredia prej 24.350 milionë euro është disbursuar në shumën 9 214 898 euro ose rreth 37.55% të totalit të kredisë. Kjo shumë përfshin dy kontratat e mësipërme dhe kontratën e supervizionit për Levan-Vlorë, kontrata e të cilit është lidhur në vlerën 703 700

euro dhe disbursuar në shumën 70 370 euro, shume që i korrespondon 10% të paradhënies së kontratës. Ndërkohë që për segmentin Fier-Levan nuk është lidhur asnjë kontratë nga vlera e parashikuar prej një milion euro.

Duke analizuar të dhënat e mësipërme mbi shkallën e disbursimit dhe afatin kohor që është marsi i vitit 2008, kohë në të cilën duhet të mbyllet punimet në segmentin rrugor, mund të shprehemi se kontraktori është akoma larg realizimit të objektit të kontratës dhe respektimit të afateve kohore.

*Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësin ose legjislacionin shqiptar për realizimin e prokurimeve për ndërtime, shërbime e mallra dhe lidhja e kontratave e zbatimi i tyre*

Për projektin “Ndërtimi dhe supervizioni i segmentit rrugor Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë” është nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe perfaqësuesve italiane, marrëveshja financiare për përdorimin e financimit prej 24 350.000 milionë euro si kredi ndihme.

Në marrëveshjen e nënshkruar më 25.02.2004, për realizimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnjë-Fier dhe supervizionin e punimeve për dy segmentet vijues Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë në nenin 3 të saj, paragrafi i fundit shprehet se: “Zbatimi i programit përfshin veprimtaritë e ndërtimit dhe supervizionit të punimeve të cilat do të jepen ndërmjet procedurave të ndryshme të tenderimit të rezervuara për shoqëritë italiane”.

Tenderat do të kryhen sipas dispozitave të parashikuara në Manualin e Procedurave të Komisionit Evropian lidhur me: “Kontratat e shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta”.

Procedurat e tenderit dhe ekzaminimi i ofertave do të kryhet nga një komision i ngritur nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve më hollësisht janë përshkruar kërkesat specifike në anekset 1-2-3 të marrëveshjes së zbatimit të programit të cilat në fund patjetër do të kenë miratimin nga Ambasada Italiane.

Nga kontrolli i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve përfaqësuar nga DPRR janë zhvilluar dy tendera të hapur ndërkombëtar për shërbimin e supervizionit dhe për kontratën e ndërtimit të segmentit rrugor Lushnje - Fier.

#### *Shërbimi i supervizionit*

- Urdhërprokurimi nr. 642, datë 23.02.2005;
- Procedurë prokurimi (udhëzuesve të BKE);
- Data e zhvillimit tenderit 07.04.2005;
- Data e lidhjes së kontratës 01.11.2005;
- Vlera e kontratës 693 000 euro.

Procedurat e tenderimit nga Drejtoria e Rrugëve për kontratën e supervizionit kanë filluar me njoftimin në gazetë të datës 16.02.2005, fondi limit i parashikuar është në vlerën 900 000 euro, dhe kanë përfunduar më datë 28.07.2005, me aktin e gjykimit nga kryetari i entit prokurues i cili miraton vlerësimin e bërë nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe gjykon në formë përfundimtare bashkimin e përkohshëm të 2 shoqërive, si fituese të garës me vlerën më të ulët të ofertës 693 000 euro.

Gjatë kontrollit të procedurës mbi bazën e dokumenteve nuk u vërejtën shkelje apo shmangie të procedurave të parashikuara në marrëveshjen e përmendur më lart.

2. Procedura e tenderit të hapur ndërkombëtar për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnjë-Fier nuk u kontrollua nga grupi i kontrollit pasi Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndodhej në proces gjyqësor për këtë tender, paditur më 4 korrik 2005, për anulimin e vendimit të komisionit të vlerësimit, si dhe detyrimin e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacioneve për të shlyer dëmin e shkaktuar shoqërisë pjesëmarrëse në tender. Çështja vazhdon të jetë në proces gjykimi dhe Gjykata nuk është shprehur akoma me një vendim të saj.

### *Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime*

Mbi kontrollin e kryer për zbatimin e kontratës “Ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë-Fier”.

Nga kontrolli rezultoi se:

Më datë 01.11.2005, ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit (MPPTT) dhe shoqërisë është lidhur kontrata për zbatimin e objektit “Ndërtimi i segmentit Rrugor Lushnjë-Fier”, me vlerë 17 545 255 euro. Data e fillimit të punimeve është jo më vonë se 180 ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Projekti për ndërtimin e këtij aksi rrugor është realizuar nga shoqëria konsulente.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve nuk ka patur oponencë teknike për projektin e mësipërm, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 6, kreu III, duke ngarkuar me përgjegjësi ish-drejtorin.

Nga verifikimi në vend i punimeve të objektit si dhe i dokumentacionit të dosjes teknike të zbatimit vërejmë se punimet në këtë objekt kanë filluar më datë 27.3.2006, sipas procesverbalit të mbajtur nga palët. Koha në dispozicion për punimet është 24 muaj dhe data 26.03.2008 është data e përfundimit të punimeve. Gjatë zbatimit të punimeve, MPPTT dhe shoqëria ndërtuese kanë nënshkruar tre shtesa kontrate, ku në to përfshihen variantet teknike të kërkuara nga kontraktori dhe mbikëqyrësi i punimeve.

1. Shtesa e parë nënshkruar më datë 03.4.2007 ka dy variante teknike:

- Përzierja me gëlqere e dheut natyror;
- Zëvendësimi i tombinove prej betoni me tombino llamarine të valëzuar.

Me realizimin e këtyre varianteve teknike, projekti kursehet me 152 453 euro.

2. Shtesa e dytë nënshkruar më datë 11.04.2007 ka katër variante teknike:

- Ndryshime të specifikimeve teknike;
- Mbrojtja e tubit të gazit në km 1+100, pjesa B;
- Ndryshimi i pjesës përfundimtare të pjesës B dhe eliminimi i rrethrotullimit të Fierit;
- Strukturat shtesë.

Për realizimin e varianteve të mësipërme kërkohet një kosto shtesë prej 151 306 euro, e cila mbulohet nga kursimi i projektit në shtesën e parë.

3. Shtesa e tretë nënshkruar më datë 08.5.2007 përbëhet nga tre variante teknike:

- Ndryshimi i shtresave të rrugës duke futur mikscimento;

- Ndryshimi i niveletës vertikale në pjesën B;
- Strukturat shtesë.

Në realizimin e këtyre varianteve projekti, kursehet me 79 021 euro.

Me propozim të mbikëqyrësit të punimeve, këshilli teknik i DPRR vendosi të miratojë më datë 08.06.2007, ndërtimin e segmentit rrugor me gjatësi L= 150 m, që lidh rotondon ekzistuese në dalje të By Pass Lushnjë, me progresivin 0+00 të aksit të ri. Gjithashtu, ky këshill teknik më datë 15.06.2007 ka miratuar propozimin për modifikimin e urave në km 0+317 dhe km 1+545 të pjesës B, si dhe drenazhimin e pjesës së mesit të rrugës.

Gjatë kontrollit rezultoi se kontraktori po punon për ndërtimin e urave pa u realizuar negocimi i çmimeve, si dhe firmosur shtesa nga autoritetet përgjegjëse, në kundërshtim me nenin 33.8 të kontratës që thotë: “Çdo ndryshim kontraktual duhet të formalizohet nëpërmjet një adendumi kontraktual, i nënshkruar nga të gjitha palët e interesuara dhe i nënshkruar no objection nga enti financues”.

Për sa më sipër, pagesa e kryer për zërin e punimeve “Pilota betoni  $\Phi$  1000 mm”, me vlerë 92 933 euro, përbën shkelje procedurale, duke ngarkuar me përgjegjësi firmën mbikëqyrëse të punimeve dhe drejtorin e projektit.

Gjithashtu konstatojmë se duke mos patur oponencë teknike, projekti i zbatimit ka ndryshuar në një pjesë të madhe të tij. Për të realizuar këto ndryshime të kërkuara të projektit, kontraktori së bashku me mbikëqyrësin e punimeve kanë marrë aprovimin e DPRR për variantet e tyre teknike (ndryshimet e projektit), pasi në vlerësimet e tyre, projekti fillestar kishte mangësi, si dhe nuk jepte siguri në disa segmente të tij. Në të gjithë variantet teknike të miratuara, krahas përsosmërisë theksohet si alternativë shkurtimi i kohës në realizimin dhe përfundimin e këtij segmenti rrugor.

Nga kontrolli i dokumentacionit vërejmë se nga ana e PIU-t evidentohen shqetësime serioze në ecurinë e punimeve të këtij projekti të rëndësishëm. Vonesat vijnë për shkak të furnizimit të pakët me material mbushës, duke lënë pa prodhim edhe impiantin e prodhimit të mikscimentos. Gjithashtu, impianti i prodhimit të asfaltit ka patur shumë probleme serioze. Këto probleme vihen re në km 5+250 deri km 5+300, ku provat laboratorike pas shtrimit të shtresës me binder rezultojnë jashtë tolerancave teknike. Si rrjedhim, kontraktori nuk është paguar dhe është urdhëruar për prishjen dhe zëvendësimin e kësaj shtrese. Gjithashtu ka patur probleme të bazës asfaltike, të cilat janë konstatuar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe kontraktori është urdhëruar për rregullimin e pjesëve të dëmtuara. Me gjithë vonesat në grafikun e punimeve, kontraktori në vend të mobilizohej, ka ulur rritmet punës, duke bërë pushimet e muajit gusht.

Në shkresën e datës 25.7.2007 të PIU-t, drejtuar drejtorit të përgjithshëm të DPRR dhe drejtorit të PIT thuhet se: “Për fat të keq, problemet që diskutohen në mbledhjet periodike nuk zgjidhen nga firma dhe ka një zvarritje të theksuar, që bien në kundërshtim edhe nga ana kontraktuale”.

Duke qenë se nga ana e PIU-t konstatohen probleme gjatë ecurisë së projektit, si dhe vonesa të mëdha në zbatimin e punimeve sipas grafikut të miratuar, në bazë të nenit 58 “Shkelje të kontratës”, PIU dhe MPPTT në rolin e porositesit, duhej të merrnin masa për kontraktorin.

Edhe pse në të gjithë ndryshimet projektit të miratuara nga palët, efekti kohë për realizimin e projektit është në favor të kontraktorit, rritmet e punës në kantier janë të ngadalta. Realizimi fizik i projektit në momentin e kontrollit është në masën 34% ndërkohë që realizimi kohor është 70.8%.

Një problem për zbatimin e kësaj rruge me shpejtësi dhe në kohë është dhe problemi i shpronësimeve. Kjo gjë vërehet në km 6+500 deri në km 7+225, ku pronarët e truallit nuk janë shpronësuar. Mosbashkërendimi i strukturave që duhet të merren me zgjidhjen e këtyre problemeve, do të sjellë vonesa në përfundimin e rrugës, e për pasojë do të kemi rritje të kostos së projektit.

Në lidhje me matjet në terren, për zërin e punimeve “shtresë asfalti 10 cm”, firma zbatuese është likuiduar në sasinë 959 m<sup>2</sup>, ndërsa në fakt janë realizuar 544 m<sup>2</sup>. Sasia prej 415 m<sup>2</sup>, me vlerë 2 523 euro (415 m<sup>2</sup> x 6.08 euro/m<sup>2</sup>), ekuivalent me **310 329 lekë** është përfituar në mënyrë të padrejtë nga firma zbatuese, duke i sjellë **dëm ekonomik buxhetit të shtetit**.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezultoi se në trupin e rrugës kalonin tuba gazi, të cilët ishin të paazhurnuar në projektin e dhënë për zbatim. Kështu që lindi si detyrë punimi i variantit teknik nr. 4, që kërkon spostimin e tubave të gazit. Për të bërë këtë spostim u kërkuar nënkontraktorë të specializuar, pasi kjo punë nuk mund të kryhej nga firma zbatuese. Nënkontraktorët e interesuar ofruan preventivin në vlerë 3 676 834 lekë (pa t.v.sh.) për të realizuar punën e kërkuar. Mbi këtë vlerë, firma zbatuese ka llogaritur për llogari të saj 15% fitim dhe shpenzime të përgjithshme, që shkojnë në vlerë 551 525 lekë. Ky veprim është në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 08.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Për rrjedhojë, vlera **551 525 lekë** e llogaritur në favor të 2 shoqërive përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**.

Si përfundim firma e zbatimit ka përfituar padrejtësisht në total shumën **1 034 224 lekë** (861 854 lekë + 20% t.v.sh.), duke i shkaktuar **dëm ekonomik buxhetit të shtetit**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyerjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duke ngarkuar me përgjegjësi përfaqësuesin shoqërisë mbikëqyrëse të punimeve dhe drejtorin e PIU-t.

*Mbi dokumentet shoqëruese të kërkesës për shpronësim dhe njoftimi për shpronësim publik, mbi kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, mbi aktmarrëveshjet si titull ekzekutiv, respektimi i afatit të lidhjes së saj si dhe dokumentacioni i nevojshëm shoqërues, mbi dokumentet që vërtetojnë vlerën e shpenzimeve procedurave të shpronësimeve*

Nga kontrolli rezultoi:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (Sektori i Shpronësimeve) me shkresën nr. 6029, datë 05.11.2003 i drejtohet firmës projektuese për të vënë në dispozicion të kësaj drejtorie projektin e plotë të zbatimit së bashku me planimetrinë, e sektorit rrugor Lushnjë-Fier.

- Këshilli i Qarkut Fier me vendimin nr. 1, datë 27.02.2004, ka miratuar lejen e ndërtimit të projektit teknik të autostradës Lushnjë-Fier.

- DPR me shkresën nr. extra, datë 07.06.2004, i drejtohet Sektorit të Shpronësimeve me të cilën informon se projekti i zbatimit për autostradën Lushnjë-Fier i hartuar nga firma konsulente në dhjetor 2003 është në përputhje me termat e referencës së hartuar nga kooperacioni italian dhe miratuar me vendimin e Këshillit Teknik të DPRR-së.

2. KRRTRSH ka miratuar me vendimin nr. 1, datë 18.01.2006 “Për miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit, për superstradën Lushnjë-Fier”, si dhe për rrugët dytësore të saj, në të cilën përcaktohet:

a. Leja e ndërtimit jepet për një periudhë 18-mujore, nga data e këtij vendimi.

b. Gjatë autostradës, në të dy anët e saj të lihet brezi i rezervuar me gjerësi 40 m, në të cilën nuk lejohet të kryhen ndërtime.

c. Ti sugjerohet MPPTT si dhe Ministrisë së Financave të parashikojë fondet për ndërtimin e rrugëve dytësore të autostradës Lushnjë-Fier.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve me shkresën nr. 2860, datë 07.6.2004 “Dërgohet kërkesë për shpronësim, për autostradën Lushnjë-Fier” i drejtohet Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacionit, në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të pasurisë pronë private për interes publik”, së bashku me argumentin juridik për shpronësimet për këtë segment rrugor.

4. Projekti i zbatimit është hartuar nga kompania konsulente dhe me nënkontraktor për aspektin topografik kompania tjetër.

- Nga kontrolli rezultoi se projekti është hartuar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, pika 46, germa i, duke përcaktuar edhe listat sipas zërave kadastror të pronarëve për t’u shpronësuar, si dhe nga ana e kësaj kompanie është kryer, krahas rilevimit të detajuar edhe evidentimi i të gjithë ish-pronarëve pretendent për sipërfaqet përkatëse për të gjithë gjerësinë e rrugës dhe shpronësimit.

- Nga ana e projektuesve është paraqitur pranë DPRR-së një draft i planimetrisë së shpronësimeve me një listë prej 600 pronarësh, pretendent për t’u shpronësuar.

- Nga shqyrtimi i këtij materiali nga Sektori i Shpronësimeve nga njëra anë dhe kontaktimi me ZRPP Lushnjë dhe ZRPP Fier nga ana tjetër, për të kryer identifikimin dhe verifikimin tekniko-juridik të masës dhe legjitimitetit të pronësive për t’u shpronësuar, ka rezultuar mospërputhje.

- Për këtë qëllim, nga ana e DPRR-së, lista e pronarëve për shpronësim është botuar disa ditë rresht në një gazetë kombëtare, duke theksuar se “vetëm ata persona fizik ose juridik që zotërojnë dokumentin e pronësisë do të marrin masën e kompensimit për atë masë të dëmtimit të shkaktuar nga zbatimi i projektit”, kjo e bazuar në nenin 20, pika “d”, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të pasurisë pronë private për interes publik”.

Në këto kushte, nga ana e DPRR-së, në bashkëpunim me grupin projektues dhe ZRPP-të e rretheve Lushnjë e Fier, është ndërmarrë edhe njëherë azhurnimi i parcelave dhe objekteve pasuri private dhe respektivisht identifikimi dhe evidentimi i secilit pronar ligjor, shoqëruar me sasinë e pronës së prekur nga zbatimi i projektit.

5. Shpronësimet, faza e parë, janë kryer me VKM nr. 784, datë 5.11.2004 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i autostradës Lushnjë-Fier”.

6. Shpronësimet, faza e dytë, janë kryer me VKM nr. 779, datë 14.12.2005 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i autostradës Lushnjë-Fier dhe për një ndryshim në VKM nr. 784, datë 05.11.2004”.

*Kontrolli i shpronësimeve të miratuara me vendimin e mësipërm është kryer me programin e kontrollit të KLSH-së nr. 914/1, datë 11.12.2006 dhe në zbatim të këtij programi është mbajtur procesverballi nr. 1, datë 11.01.2007.*

7. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, relacioni për shpronësimin shtesë në këtë segment rrugor, dërguar Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve është bërë për këto arsye:

a. Si rezultat i shtesave, modifikimeve dhe spostimit të aksit në fund të seksionit.

b. Nga saktësimi i sipërfaqeve të pronave të prekura nga ky aks rrugor.

Nga kontrolli rezultoi:

- Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, me vendimin e Këshillit Teknik datë 14.12.2006 "Propozimet për hyrje-dalje në aksin rrugor Lushnjë-Fier" ka miratuar studimin e hartuar nga supervizori, për aksin rrugor Lushnjë-Fier.

- DPRR me shkresën nr. extra, datë 14.02.2007 i dërgon zyrtarisht Sektorit të Shpronësimeve, planimetrinë e shpronësimeve shtesë për segmentin rrugor Lushnjë-Fier, si rezultat i shtesave, modifikimeve dhe spostimit të aksit në fund të seksionit, sipas propozimeve të hartuara nga supervizori dhe të miratuara nga zyra e PIU-t.

- DPRR në zbatim të ligjit të mësipërm ka botuar në gazetë zyrtare të datës 17.05.2007 "Shpallje kërkesë për shpronësim".

8. Kontroll në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", neni 31, përcakton shprehimisht:

"Në zbatim të studimeve urbanistike të të gjitha llojeve, sipas fazave të realizimit të tyre në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera nënligjore, bëhet shpronësimi në përputhje të plotë me studimin, me vlerësimin e pasurive të paluajtshme pronë private dhe me procedurat përkatëse për shpronësim".

VKM nr. 722, datë 19.11.1998 "Për miratimin e rregullores së urbanistikës", pika 46 përcakton shprehimisht:

"Studimi urbanistik pjesor tregon kufijtë e zonës së përfshirë prej tij dhe përmban:

- Germa "i" - listat sipas zërave kadastrorë të pronarëve për t'u shpronësuar ose do t'iu vihen kushtëzime të caktuara".

Nga kontrolli në lidhje me saktësinë e sipërfaqeve të shpronësuar dhe të miratuara me VKM nr. 877, datë 22.12.2004, si dhe për sipërfaqet që propozohen me listën rezultoi se:

a. Është zbatuar plotësisht ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 dhe VKM nr. 722, datë 19.11.1998, për arsye se në detyrën e projektimit është zbatuar projekti i zbatimit të planimetrisë së shpronësimeve.

b. Nga kontrolli i planimetrisë së ndërtimit të rrugës Lushnjë-Fier, sipas draftit të dërguar nga firma konsulente e huaj dhe të miratuara nga zyra e PIU-t, ku projekti i zbatimit është hartuar nga kompania konsulente dhe me nënkontraktor për aspektin topografik, rezultoi se në këto planimetri të hartuara sipas plansheteve dhe zonave kadastrale përkatëse, janë përcaktuar saktësisht sipërfaqet e pronave (sipas plansheteve, zonave kadastrale dhe HTR-ve të lëshuara nga ZVRPP Lushnjë dhe Fier), që preken nga ndërtimi i kësaj rruge dhe të përcaktuara saktësisht në listat përkatëse të shpronësimit shtesë.

9. Kontroll mbi zbatimin e VKM nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik".

A. Sektori i Shpronësimeve e DPRR me shkresën nr. 689, datë 14.02.2007 drejtuar ZRPP Fier, me të cilën kërkon çmimet e shitblerjeve të pasurive për tremujorin e fundit, si dhe konfirmimin e pronësisë për 41 pronarë, sipas listës përkatëse, për pasuritë e të cilëve preken si rezultat i spostimit të projektit të autostradës Lushnjë-Fier në pjesën fundore të saj.

- ZRPP e Fierit në përgjigje të shkresës së mësipërme me shkresën nr. 198/1, datë 15.02.2007 i dërgon konfirmim mbi gjendjen juridike të pronësisë të pasurive që preken si rezultat i spostimit të projektit të autostradës Lushnjë-Fier, si dhe çmimin mesatar të shitblerjeve për pasurinë “arë” prej 1200 lekë, por theksohet se “çmimi në kontratat e shitblerjeve janë të manipuluar dhe nuk janë reale”.

- Sektori i shpronësimeve i DPRR me shkresën nr. 689, datë 14.02.2007 i drejtohet ZRPP Fier, me të cilën i kërkon çmimet e shitblerjeve të pasurive për tremujorin e fundit, si dhe konfirmimin e pronësisë për 17 pronarë, pasuritë e të cilëve preken si rezultat i përmirësimit të projektit përfundimtar të zbatimit të autostradës Lushnjë-Fier.

- ZRPP Lushnjë në përgjigje të shkresës së mësipërme me shkresën nr. 100/1, datë 19.02.2007 i dërgon konfirmim mbi gjendjen juridike të pronësisë të pasurive që preken si rezultat i spostimit të projektit të autostradës Lushnjë-Fier si dhe çmimin mesatar të shitblerjeve për pasurinë “arë” prej 1000 lekë, por theksohet se “çmimet në kontratat e shitblerjeve janë të manipuluar prandaj nuk janë reale”.

Nga kontrolli rezultoi se çmimet e vendosura sipas llojit të pasurive rezultojnë në përputhje të plotë me çmimet e rezultuara për tremujorin e fundit dhe të dërguara me shkresat e mësipërme nga ZRPP Lushnjë dhe ZRPP Fier.

Në total, sipërfaqja e shpronësuar rezulton 75 968 m<sup>2</sup> tokë arë, të vlerësuar me 1 000 lekë/m<sup>2</sup> për zonën e Lushnjës dhe 1 200 lekë /m<sup>2</sup> për zonën e Fierit, me vlerë totale 90 116 960 lekë.

B. Në lidhje me vlerësimin e kulturave bujqësore rezulton se vlerësimet janë bërë konform dispozitave ligjore në fuqi dhe vlera e shpronësimeve rezulton 227.108 lekë për kultura bujqësore dhe 516 961 lekë dru frutorë.

C. Në lidhje me vlerësimin e pasurive të paluajtshme, si: objekte industriale, bujqësore, pika karburanti etj.

Nga kontrolli rezultoi se në listën e shpronësimeve shtesë nuk rezultojnë objekte industriale dhe godina banimi.

*Kontroll mbi rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit për shpronësimet dhe detyrat e sekretarisë teknike e ngritur pranë Ministrisë së Transporteve dhe Punëve Publike si dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve*

1. DPRR me shkresën nr. 6103, datë 30.08.2007 “Relacion për shpronësimet shtesë në segmentin Lushnjë-Fier” dhe kërkesë e përsëritur për përfshirjen e kulturave bujqësore dhe serave”, i dërgon Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit gjithë dokumentacionin shoqërues së bashku me listën përfundimtare si dhe relacionin përkatës.

- Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve mbas shqyrtimit të materialit të dërguar nga DPRR-ja për shpronësimet shtesë, në segmentin rrugor Lushnjë-Fier, ka dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave, listën përkatëse pa asnjë ndryshim.

- Lista e shpronësimeve shtesë ka dalë me VKM nr. 670, datë 10.10.2007 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme,

pronë private, që preken nga ndërtimi i autostradës Lushnjë-Fier”, në të cilin përcaktohet:

a. Në total, sipërfaqja e shpronësuar rezulton 75 968 m<sup>2</sup> tokë arë, të vlerësuar me 1 000 lekë/m<sup>2</sup> për zonën e Lushnjës dhe 1 200 lekë/m<sup>2</sup> për zonën e Fierit me vlerë 90 116 960 lekë.

Për kultura bujqësore, vlera e shpronësimeve rezulton 227.108 lekë dhe 516 961 lekë dru frutorë.

Në total, vlera e përgjithshme e shpronësimeve rezulton 90 861 029 lekë, vlerë kjo e cila përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

2. Shpenzimet procedurale zënë vlerën prej 705 700 lekë, e cila do të përballohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

3. Shpronësimi do të fillojë më 15.10.2007 dhe do të përfundojë më 15.11.2007.

4. Për pronarët e përcaktuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentecioni”, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dokumentecionin e plotë të pronësisë.

Për përmirësimin e gjendjes, nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit u rekomanduan masa organizative, si dhe masa për zhdëmtim ndaj personave përgjegjës për demin ekonomik të shkaktuar.

### 3. KONTROLL NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT, QARKU I LEZHËS

Në zbatim të programit të kontrollit nga data 17.10.2007 deri në datën 23.11.2007, u ushtrua kontroll në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Qarku Lezhë, me objekt kontrolli “Për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të lejes, pëlqimit dhe autorizimit mjedisor, përsëritjen e lejes mjedisore, si dhe të monitorimit e administrimit të mbetjeve”, për periudhën 01.01.2004 - 23.11.2007.

Kontrolli u krye për zbatim ligjshmërie dhe vlerësues, duke verifikuar sipas rastit dokumentecionin e plotë dhe me zgjedhje.

Nga kontrolli i ushtruar rezultoi:

#### *Mbi zbatimin e detyrave të lëna nga Kontrolli i mëparshëm*

Me shkresën nr. 292/6, datë 23.05.2001, Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Qarku Lezhë i është dërguar raporti përfundimtar, si dhe detyrat e lëna për zbatim.

#### *Realizimi i detyrave u konstatua si më poshtë:*

Grupi i kontrollit konstatoi se nga dhjetë detyra të rekomanduara, tre detyra janë realizuar nga ARM, ndërsa shtatë prej tyre janë realizuar pjesërisht ose janë në proces realizimi.

Detyrat e lëna si dhe zbatimi i tyre i referohen legjislacionit për mjedisin që ka qenë në fuqi deri në vitin 2002.

#### *Mbi kontrollin e zbatimit të procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis.*

Në zbatim të ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, grupi i kontrollit i kërkoi ARM, Qarkut Lezhë dokumentecionin ku të ishin pasqyruar nga kjo Agjenci procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe iu vu në dispozicion dokumentecioni jo i plotë mbi mënyrën se si kjo agjenci ka proceduar

për vlerësimin e ndikimit në mjedis, të projektit që do të zbatohet ose ushtrohet veprimtaria nga ana e subjekteve të cilat kanë aplikuar për t'u pajisur me leje, autorizim apo pëlqim mjedisor.

Pranë kësaj agjencie mungon regjistri ku të jetë pasqyruar kërkesa e subjektit për miratimin e projektit dhe dokumentecioni shoqërues, nuk ishin pasqyruar afati kohor i shqyrtimit fillestar të dokumentecionit dhe nëse ka pranuar shqyrtimin e kërkesës dhe dokumentecionin shqyrtues, ka hedhur poshtë kërkesën, nëse dokumentet nuk janë hartuar sipas kërkesave 8 e 11, të ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" dhe të ketë njoftuar me shkrim propozuesin për plotësimet e rregullimet që duhet t'u bëjë dokumenteve.

Nuk u gjet dokument shkresor, ku sipas shtojcës 1 e 2, të ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003, të ishte bërë klasifikimi i projektit të propozuar nga subjekti brenda pesë ditëve nga data e marrjes në dorëzim të kërkesës.

Nuk u gjet dokument shkresor që nga ana e saj të jenë vëzhguar në vend të dhënat e paraqitura në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Nuk u gjetën të dhëna ku kjo agjenci të jetë këshilluar me organet e qeverisjes vendore të rretheve përkatëse, ku do të zbatohet projekti si dhe me organizma të zhvillimit urban dhe turistik.

Nuk u gjet dokument shkresor ku agjencia të ketë paraqitur mendimin e vet të argumentuar nëse është dakord ose jo me projektin e propozuar, apo të ketë propozuar kushtet që duhen vendosur në dokumentin e miratimit.

Nuk u gjet protokollin ku kjo agjenci të vërtetojë se i ka përcjellë në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dokumentecionin e subjekteve që aplikojnë për leje mjedisore, pasi nuk ka punonjës të ngarkuar për mbajtjen e protokollit.

Grupi i kontrollit nuk mund të gjykojë nëse është zbatuar afati kohor prej njëzet ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës, nga ARM, Qarku Lezhë, deri në dorëzimin e saj në Ministrinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, që është edhe faza përgatitore.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 8, 10, 11, 14, 15, të ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të kontrollit, për vitet 2004, 2005, 2006, nga ana e ARM, Qarku Lezhë janë shqyrtuar dhe pajisur me leje mjedisore, nga Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, 70 subjekte, si dhe nga ana e ARM janë pajisur me autorizim mjedisor për vitet 2004, 2005, 2006, 34 subjekte.

ARM, Qarku Lezhë, në shqyrtimin e dokumentecionit për lejet mjedisore dhe përcjelljen e tyre për shqyrtim dhe aprovim në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe për rastet kur ajo ka shqyrtuar dokumentecion dhe ka dhënë autorizimet mjedisore, që janë kompetencë e agjencisë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 69, të ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", si dhe të nenet 6, 10, 11 e 14, të ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", pasi kjo agjenci në përbërje të saj ka vetëm kryetarin e agjencisë dhe nuk ka të plotësuar strukturën për të dhënë mendim apo për të marrë vendim sipas kompetencave që jep ligji.

Dokumentecioni për vlerësimin e ndikimit në mjedis të paraqitura nga subjektet fizike dhe juridike dhe për t'u pajisur me leje mjedisore apo autorizim mjedisor është shqyrtuar në mënyrë individuale nga kryetari i ARM-së, për rrethin e Lezhës dhe individualisht nga inspektorët e mjedisit në rrethet përkatëse Kurbin

dhe Mirditë ku kryejnë detyrën, si dhe janë përcjellë po nga ana e tyre pranë ministrisë deri në qershor të vitit 2006 dhe nuk është mbajtur kopje e këtij dokumentecioni pranë ARM-së.

Në pikën 3, neni 69, të ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, citohet: “Rregullat e hollësishtme për organizimin, funksionimin dhe sistemimin e Agjencive Rajonale të Mjedisit, caktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Mjedisit”, gjë e cila nuk u vu në dispozicion nga ana e ARM-së në periudhën e ushtrimit të kontrollit.

Agjencia Rajonale e Mjedisit, Qarku Lezhë, funksionon mbi bazën e Rregullores nr. 4, datë 26.12.2003, ku ndër të tjera në gjermën b, pikat 3 dhe 4, citohet se ARM-ja varet nga kryeinspektori i Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe raporton para tij, përcaktim i cili bie në kundërshtim me nenet 69 dhe 70, të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Ruajtja e dokumentecionit nuk është bërë në përputhje me nenin 29, të ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, si dhe të nenit 24, germa b dhe neneve 4 e 5, kapitulli II, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

I gjithë zbatimi i procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis është në kundërshtim me ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, për të cilën mbajnë përgjegjësi kryetarët e ARM, Qarku Lezhë sipas periudhave përkatëse 01.01.2004 - 12.05.2006 dhe 13.05.2006 – 31.12.2006.

#### *Mbi kontrollin e zbatimit të procedurave të monitorimit të mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi*

Grupi i kontrollit kontrolloi zbatimin e nenit 52, pika 2, e ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i cili thekson: “Monitorimi i cilësisë së mjedisit, i ndotjes dhe i dëmtimit të tij dhe biodiversitetit përfshin tokën, ujin, ajrin, florën e faunën dhe lidhjet e tyre me shëndetin”, dhe konstatoi në bazë të kontrollit të dokumentecionit të vënë në dispozicion nga ARM Qarku Lezhë se për vitet 2004, 2005, 2006, situata mjedisore në Qarkun e Lezhës është si më poshtë:

A. Qarku i Lezhës ka një sipërfaqe 1 619,1 km<sup>2</sup> ose 161 910 ha tokë bujqësore. Toka bujqësore zë një sipërfaqe prej 35 152 ha ose 22%. Në rrethin e Lezhës toka bujqësore zë një sipërfaqe prej 62%, në rrethin e Kurbinit 61% dhe në rrethin e Mirditës 26%.

#### *Pyjet*

Në Qarkun e Lezhës pyjet zënë një sipërfaqe 93 134 ha ose 58%, Mirdita paraqitet me sipërfaqe më të madhe në qark me 86 700 m<sup>2</sup>, Kurbini 10 710 m<sup>2</sup> ose 39%, Lezha 18 234 m<sup>2</sup> ose 38%. Një nga problematikat që ka të bëjë me administrimin e fondit pyjor në Qarkun e Lezhës evidentohet shkalla e dëmtimeve të këtij fondi, e cila mbetet mjaft shqetësuese.

- Dëmtimet janë të mëdha në prerje të pyjeve, kryesisht për materiale drusore si dhe tregtimi i paligjshëm i materialit drusor.

- Zënia me dhe pa leje e këtij fondi nga hapja e guroreve, pa një strategji apo planifikim të përshtatshëm.

- Mungesa e mbjelljeve sipërfaqeve të reja me pyje si rrjedhojë e mungesës së fondeve për krijimin e fidanishteve pyjore.

- Erozioni mbetet mjaft aktiv, në një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore prej 5500 ha të fondit të përgjithshëm pyjor, kryesisht në Zadrimë, Blinishtë, Kallmet rreth 3800 ha, Kolsh e Zejmen me një sipërfaqe prej 1700 ha, shkaqet e të cilave janë mungesa e bimësisë si dhe mungesa e disiplinimit të ujërave sipërfaqësor.

- Varfërimi i biodiversitetit është i konsiderueshëm, veçanërisht në zonat e mbrojtura dhe ato të zonës bregdetare.

- Proçesionaria e pishës ka një përhapje infeksioni 15-20% të numrit të drurëve në një sipërfaqe prej 25 ha, në të cilën nuk ka të planifikuar masa luftimi për mungesë fondesh.

- Gjatë vitit 2004 janë identifikuar 8 raste të rënies së zjarreve, ku kanë përshkuar një sipërfaqe prej 31.3 ha, nga e cila e djegur 3.84 ha, lënda drusore e djegur është 40 m<sup>3</sup> me vlerë 427 mijë lekë.

Gjatë vitit 2004 është zbatuar projekti i financuar nga buxheti i shtetit me vlerë 2.4 milionë lekë, i aplikuar në komunat Kolsh, Balldren dhe në rezervatin Kune - Vain i cili ka dhënë rezultate të mira në mbjelljen dhe zënien e drurëve pyjorë.

Interes paraqet puna e bërë në kuadrin e “Projektit të pyjeve”, financuar nga Banka Botërore mbi mbarështimin e disa ekonomive pyjore si dhe procesi i inventarizimit të fondit të pyjeve.

### *Erozioni*

Erozioni është një fenomen shqetësues në Qarkun e Lezhës. Sipërfaqja nën erozion është 4 350 ha fenomen i cili është në vazhdimësi gjatë gjithë vitit, sipërfaqja e prekur rëndë është 236 ha.

Degradimi i tokës bujqësore nga gërryerjet dhe përmbytjet mbetet problem serioz i cili ka dëmtuar shtresën aktive në mbi 30 000 ha tokë bujqësore si dhe dëmtimin e mjaft pritave malore, urave, akseve të rrugëve nacionale e rurale, problem i cili ka ndikuar ndjeshëm në dëmtimin e shtresës aktive të tokës, si dhe të cilësive fiziko-kimike të tokës bujqësore, e cila ka ndikuar ndjeshëm në rënien e prodhimit të kulturave bujqësore.

Zhvillim intensiv ka erozioni bregdetar në zonën e Kunes. Në të gjithë bregdetin e këtij rezervati deti ka avancuar në drejtim të tokës, me 2 deri në 3 m në vit. Ky erozion ka shkaktuar shkuljen e pishave, drunjve të tjerë të bregdetit si dhe kripëzimi ka avancuar duke dëmtuar e tharë sipërfaqe të konsiderueshme të këtij rezervati. Në rrethin e Kurbinut erozioni i tokave të larta bujqësore është intensiv dhe konstant. Shtretërit e lumenjve Mat e Droje janë nën trysinë e një shfrytëzimi intensiv.

### *Biodiversiteti*

Në vijën bregdetare prej 38 km të Qarkut Lezhë gjenden zonat e mbrojtura Kune-Vain dhe Patok-Negel, ndër më interesantet e vendit tonë. Habitatet karakteristike të këtij bregdeti janë: dunat ranore, ligatinat bregdetare, lagunat, pyjet halorë mesdhetarë, pyjet aluvionalë bregdetarë.

Sistemi i dunave ranore në bregdetin e Qarkut Lezhë është i zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme veçanërisht në grykëderdhjen e lumit Drin. Ky sistem është i ruajtur mirë në kushte natyrore, por nga ana tjetër, aktiviteti njerëzor nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës, urbanizimit, dhe turizmit përfaqëson një kërcënim të përhershëm dhe në rritje për ekosistemet e plazheve dhe dunave ranore. Mbi të gjitha vija bregdetare e rajonit është e kërcënuar seriozisht nga erozioni ku në disa raste zaptimi i tokës nga deti arrin deri në 3 m në vit. Ligatinat kanë një shtrirje të konsiderueshme dhe janë të mirëprezantuara në deltën e lumit

Drin e Mat. Vegjetacioni i këtyre mjediseve për vetë kushtet e ashpra të rritjes (kripshmëri shumë e lartë dhe përmbajtje të herëpashershme) paraqitet shumë i mirë. Problemet më shqetësuese në lidhje me biodiversitetin janë:

- Zgjerimi i sipërfaqeve të mbrojtura.
- Përgatitja e planeve të menaxhimit.

- Kryerja e pyllëzimeve të reja në llojet e gjinisë *Tomarix*, për vetë rëndësinë e madhe që kanë këto formacione për folemizimin e shpendëve. Nga viti 2004 e në vazhdim, si rezultat i problemeve të hasura, numri i shpendëve që dimërojnë në zonën e Kune-Vain ka ardhur në ulje, duke arritur në shifrën më të ulët në 2 318 individë dimërues, në 32 lloje shpendësh, ku rreth 47% e tyre dimërojnë në Lagunën e Vainit. Faktor tjetër i cili ka ndikuar në uljen e numrit të shpendëve si dhe llojeve të tyre është dhe gjuetia e paligjshme, përndjekja e kafshëve, kapja me qëllim tregtimi.

### *Gjelbërimi*

Në zonat urbane të qarkut, sipërfaqja e gjelbërimit ka ardhur në vite duke u zvogëluar si rezultat i ndërtimeve pa kriter dhe i merkatzimit të rrugëve. Në territorin e bashkive banojnë 98868 banorë, në një sipërfaqe të gjelbër prej 17.1 ha ose 0,17 m<sup>2</sup>/frymë.

Qyteti i Rubikut ka një sipërfaqe të gjelbër të pakonsiderueshme. Investimet për rehabilitimin e sipërfaqeve ekzistuese janë shumë të vogla dhe të pjesshme.

### *Uji*

Rajoni i Lezhës është mjaft i pasur me ujëra e përshkohet nga lumi Drin dhe Mat, duke përfunduar në grykëderdhje të tyre. Lagunat Kune, Vain, Patok, liqeni i Knallës, basenet ujëmbledhëse Kallmet Malësi, burimet nëntokësore, ujërat detare dhe peizazhe tërheqës. Të gjithë lumenjtë sipas analizave kanë një pH lehtësisht alkaline në kufijtë 7,5 - 8,5, kurse mineralizimi 200 - 400 mg/l. Nga analizat e ISH Publik Tiranë rezulton se liqeni i Knallës i cili ndodhet në hyrje të Shëngjinit, është më i ndoturi në shkallë vendi nga ujërat e zeza që shkarkohen në të. Fenomen në qytetin e Laçit ka qenë ndotja e ujit të pijshëm nga ujërat e zeza të qytetit. Si rezultat i epidemive të ndryshme ka patur shfaqje të hepatitit të evidentuara në 108 (viti 2005) raste të konfirmuara nga analizat e kryera në laboratorin kliniko-biokimik. Si rezultat i ndërhyrjeve nga ndërmarrja e ujësjellës e kanalizimeve me investime në përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimeve është përmirësuar situata në këtë drejtim.

### *Ujërat nëntokësore*

Furnizimi i popullsisë me ujë të pijshëm në Qarkun e Lezhës bëhet kryesisht nga ujërat nëntokësore dhe burimet. Ujërat nëntokësore shtrihen në pellgje në thellësi të ndryshme nga sipërfaqja dhe shfrytëzohen me shpime hidrogjeologjike. Shfrytëzimi intensiv i tyre ka krijuar disekuilibra hidrodinamikë e hidrokimikë, si dhe ka stimuluar ndotjen e ujit nga faktorë sipërfaqësorë të veprimtarisë njerëzore. Ujërat nëntokësore janë të një cilësie të mirë, por problemi kryesor është rreziku i depërtimit të ujërave të kripur si rezultat i mbishfrytëzimit. Monitorimi i ndotjes së ujërave nëntokësore ka qenë i vazhdueshëm në vite në pellgjet më kryesore si dhe në pellgjet e reja të krijuara. Në Qarkun e Lezhës, ujërat nëntokësore shfrytëzohen kryesisht për furnizimin e popullatës dhe shumë pak për industrinë ushqimore. Ruajtja dhe monitorimi i cilësisë së ujërave përbën një domosdoshmëri për të siguruar furnizimin popullatës me ujë, në sasi dhe cilësi. Mbi bazën e rezultateve të monitorimit është e nevojshme të realizohen masat të cilat sigurojnë: ruajtjen e rezervave të shfrytëzimit të ujërave nëntokësore, mbrojtjen e

vendburimeve, vlerësimin e shkaqeve të ndotjes, ruajtja me rreptësi e zonave të mbrojtjes sanitare.

#### *Ujërat e zeza*

Në lumin Fan vazhdojnë të derdhen ujërat e zeza të qytetit Rrëshen e Rubik, si dhe të zonave të tjera urbane, në mënyrë të pakontrolluar dhe të patrajtuar. Në lumin Drin shkarkohen ujërat e zeza të patrajuara dhe të pakontrolluara të qytetit të Lezhës, të zonave të tjera urbane si dhe ujërat e dy fabrikave të përpunimit të peshkut të po këtij qyteti. Rritja e urbanizimit si dhe e qendrave të reja të banimit në të dy anët e lumit Drin dhe gjatë gjithë fushës së Zadrimesë kanë rritur shkarkimet e ujërave të zeza, duke ndikuar veçanërisht në stinën e verës në përkeqësimin e cilësisë së ujërave të këtij lumi. Liqeni i Knallës i ndodhur në afërsi të Shëngjinit është më i ndoturi në shkallë vendi nga shkarkimet e ujërave të zeza të patrajuara dhe të pakontrolluara të qytetit Shëngjin. Humbja e lidhjes direkt të këtij liqeni me lagunën ka bërë që niveli i ndotjes të rritet në mënyrë të ndjeshme. Fenomen shqetësues është fakti se në të gjithë rajonin ujërat e zeza shkarkohen të pa trajtuara në ujërat e lumenjve më të afërt. Ndotja e lumit Ishëm është evidente dhe jep impakt në ujërat e detit Adriatik si humbje të transparencës, turbullim, dëmtim të florës dhe faunës në zonën përreth, uji është me ngarkesë të lartë mikrobike, e cila ka shfaqur probleme shëndetësore tek pushuesit në periudhën e verës.

#### *Ujërat e përdorura*

Ujërat e përdorura shkarkohen në zonën fushore të bregut të Matës nga zonat e banuara, tërhiqen nga Hidrovori i Tales i cili i derdh në grykën e Matkeqës për në det. Këtu kryhet lidhja e lagunës së Vainit me detin Adriatik, por si rezultat i vetëbllokimit të shpeshtë natyror të kësaj gryke, ujërat e përdorura urbane të cilat kanë përmbajtje të lartë kimikatesh si dhe ngarkesë me ujëra të zeza shkarkohen në këtë lagunë, duke rrezikuar seriozisht florën dhe faunën e kësaj lagune. Ujërat e përdorura të shkarkuara nga hidrovori në ishull Shëngjin nuk e krijojnë të njëjtin efekt sepse janë të pakta dhe gryka e kësaj lagune me detin funksionon pa ndërprerje.

#### *Ajri*

Shtimi i numrit të automjeteve ka sjellë si rezultat rritjen e shkarkimeve në ajër të produkteve të djegies së karburanteve të cilat ndikojnë në përkeqësimin e cilësisë së ajrit, e theksuar kjo në zonat urbane.

Përdorimi i karburanteve jashtë kërkesave të standardeve si dhe hyrja e makinave të përdorura deri në masën 90%, janë faktorë që rrisin nivelin e ndotjes së ajrit urban.

Krahas faktorëve që kanë ndikuar dhe ndikojnë në ndotjen e mjedisit, një faktor i cili ka ndikuar në pakësimin e ndotjes së tij (tokë, ajër) ka qenë dhe mosfunksionimi i minierave të pasurimit dhe rafinimit të bakrit në Rubik e Laç si dhe Kombinati Kimiko-Metalurgjik në Qytetin e Laçit, të cilat në periudhën e funksionimit të tyre kanë ndikuar ndjeshëm në ndotjen e tij.

#### *Mbeturinat urbane*

Në shkallë Qarku, në qytetet Lezhë, Rrëshen, Laç, Milot, Rubik, Mamurras e Shëngjin, evadohen në ditë nga firmat e pastrimit rreth 71 ton mbeturina urbane.

Problem kryesor mbeten sheshet e depozitimit të këtyre mbeturinave të cilët nuk plotësojnë kriteret në përputhje me standardet e administrimit të mbeturinave urbane.

Kështu sheshet e depozitimit për qytetet Rrëshen, Rubik ndodhen në anë të lumit Fan, ku mbeturinat hidhen në lumë pa kryer trajtimin dhe përpunimin e tyre. Sheshi i depozitimit të mbeturinave urbane për qytetin e Milotit është në breg të lumit Mat, qyteti i Laçit i depoziton mbeturinat urbane në breg të përroit në Delbnisht, qyteti i Mamurrasit i depoziton ato në bregun e lumit Drojë dhe Ishëm pa kryer trajtimin dhe përpunimin e këtyre mbetjeve. Si pasojë e këtyre depozitimeve në brigjet e lumenjve dhe derdhjen e ujërave të zeza të zonave urbane, në të cilat kalojnë këta lumenj shkaktohet ndotje e konsiderueshme në ekosistemet veçanërisht të ujërave të këtyre lumenjve. Për rastet e lumit Ishëm dhe Drojë, brigjet e detit ku derdhen këta lumenj janë të ndotur, gjë e cila është identifikuar edhe nga rezultatet e analizave bakterologjike dhe fiziko-kimike të këtyre ujërave.

#### *Mbetjet spitalore*

Mbetjet spitalore në Qarkun e Lezhës nuk trajtohen në bazë të nenit 18, ligji nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”. Mungesa e këtij trajtimi të përshtatshëm të këtyre mbetjeve vazhdon të mbetet një problem mjaft i mprehtë në të gjithë rrjetin e Shërbimit Shëndetësor në qark. Mbetjet digjen në porcione në sipërfaqe brenda komplekseve spitalore ose groposen në afërsi të shesheve të depozitimit të mbeturinave urbane, duke rrezikuar seriozisht mjedisin dhe jetën e njerëzve.

#### *Mbetjet industriale*

Një masë prej 3.865.000 ton mbetje e ngurtë (skorje) është depozituar në tokë nga subjektet e industrisë së bakrit në Rubik, Rrëshen, Reps e Perlat, ku era, reshjet dhe ujërat evadojnë vazhdimisht në terrene gjithnjë e më të përhapura në përkeqësim të mjedisit natyror.

Mbetjet e ngurta të industrisë së bakrit e kromit kanë shkaktuar ndotje të lumit Fan i cili ka shkaktuar ndikim negativ, në florën dhe faunën, ku 640 ha tokë gjatë brigjeve të lumit Fan e Urak në Mirdite është e ndotur nga sterilet e bakrit.

Aktualisht, kjo uzinë është e shkatërruar, ndërkohë impakti negativ do të vazhdojë derisa të eliminohen të gjitha burimet ndotëse në territorin e saj.

Zona e ish-Kombinatit Kimiko-Metalurgjik në rrethin e Kurbinit është vlerësuar si një nga pikat më të nxehta mjedisore, për shkak të kontaminimit të sipërfaqes së tokës me mbetje teknologjike.

Depozitimet e trashëguara janë në sasi të mëdha në trajtë lëndësh të para dhe mbetjesh teknologjike, si fluorosilikati i natriumit, oksidi i vanadiumit, asbeste etj., të cilat konsiderohen si lëndë të rrezikshme në përmbajtjen e stokeve të mëdha teknologjike (700.000 ton), si arseniku, bakri, plumbi etj. Ndotja e mjedisit është shqetësuese deri në ditët e sotme edhe pse Uzinat e ndryshme të ish-Kombinatit Kimiko-Metalurgjik në Laç, janë të mbyllura në ambientet e saj ndodhen gjendje të konsiderueshme të kimikateve dhe mbetjeve teknologjike në formë të lëndëve të para, llumrash dhe dherishte të ndotur. Kështu gjenden 800 ton të katalizatorit V<sub>2</sub>O<sub>5</sub>, me përmbajtje 0,054% arsenik, 40 ton asbest, 200 ton fluorosilikat natriumi, 0,2 ton acid fosforik, 2000 ton mbetje të pesticideve të ndryshme.

Popullimi i zonave industriale është problematik për shëndetin e banorëve në rajonin e Laçit. Gjendja e krijuar është tepër shqetësuese dhe nuk është marrë

asnjë masë për evadimin, asgjësimin dhe rehabilitimin e gjithë territorit që është kontaminuar nga këto dhe të tjera mbetje.

Për sa trajtuam më lart pranë ARM nuk u gjetën nga subjektet shtetërore dhe private plane veprimi të shoqëruara me buxhete përkatëse, për të sjellë në parametra normalë situatën mjedisore të përshkuar më lart.

### **B. Vetëmonitorimet dhe inspektimet.**

Qarku i Lezhës ka gjithsej 364 subjekte të cilat kryejnë aktivitet në rrethet përkatëse, në Lezhë 178 subjekte, në Kurbin 140 subjekte, në Mirditë 46 subjekte. Nga identifikimi i bërë rezultoi se në Lezhë kryejnë aktivitet të pajisur me leje, apo autorizim mjedisor 105 subjekte, në Kurbin 99 subjekte dhe në Mirditë 13 subjekte. Krahas subjekteve të pajisur me leje, në Qarkun Lezhë kryejnë aktivitet pa leje apo autorizim mjedisor 147 subjekte, nga të cilat 73 subjekte në Lezhë, 41 subjekte në Kurbin dhe 33 subjekte në Mirditë. Përveç subjekteve të identifikuar grupi i kontrollit konstatoi se kryejnë aktivitet pa u pajisur me leje mjedisore subjekte të cilat grumbullojnë dhe tregtojnë mjete rrugore me motor, rimorkio dhe pjesë të tyre, të dalë jashtë përdorimit ose të braktisura. Këto subjekte nuk janë identifikuar nga ana e inspektoriatit dhe ARM-së, Qarku Lezhë, veprim i cili bie në kundërshtim me pikën 1, nenin 16, kreu V, i ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor të rimorkiove dhe pjesëve të tjera të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.

Për 147 subjektet e papajisur me leje, autorizim apo pëlqim mjedisor nuk disponohen të dhëna për aktivitetin që kryejnë dhe natyrën e dëmtimit të mjedisit.

Grupi i kontrollit kontrolloi zbatimin e pikës 6, neni 53, të ligjit nr. 8934, datë 02.05.2002, i cili thekson “Monitorimi i shkarkimeve i ndotjes e dëmtimit të mjedisit për shkak të veprimtarive njerëzore dhe kur është e nevojshme edhe i dukurive natyrore që rezultojnë prej tyre, realizohet dhe përballohet nga personat fizikë e juridikë, të cilëve u përkasin veprimtaritë dhe instalimet në përputhje me lejen mjedisore”, si dhe zbatimin e VKM nr. 103, datë 31.03.2002 “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”, kreu III, germa B, pika 2, ku theksohet: “Personat fizikë dhe juridikë që janë subjekte të lejes mjedisore, të dërgojnë në Agjencitë Rajonale të Mjedisit të dhënat e monitorimit, të paktën 4 herë në vit, si dhe t’i vënë në dispozicion të inspektorëve të mjedisit, gjatë inspektimit të ushtruar prej tyre”.

Për vitin 2004 u konstatua se pranë ARM-së, kanë dërguar vetëmonitorimet nga 178 subjekte që ushtrojnë aktivitet me ndikim në mjedis vetëm 11 subjekte, nga të cilat 6 subjekte shtetërore dhe 5 subjekte private, të cilat kanë raportuar pranë ARM-së vetëm 1 herë në vit. Nga kontrolli i vetëmonitorimeve dhe analizave u konstatua se analizat për subjektet e përpunimit të peshkut ishin konform normave të lejuara dhe kryheshin pranë Institutit të Shëndetit Publik Tiranë. Subjektet shtetërore të cilat kanë dërguar të dhëna mbi vetëmonitorimin janë Drejtoria e Shëndetit Publik, Mirditë, Drejtoria e Shëndetit Publik, Lezhë, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit, Komuna Shëngjin, Drejtoria e Ujësjiellës-Kanalizimeve Lezhë, Drejtoria e përgjithshme e Transportit Laç.

Për vitin 2005 u konstatua se kanë dërguar pranë ARM-së, vetëmonitorimin dhe raportin e vetëmonitorimit 8 subjekte, nga të cilat: Bashkia Lezhë dhe komuna Shëngjin kanë dërguar të dhënat e vetëmonitorimit për administrimin e mbetjeve urbane vetëm, për tremujorin e parë. Drejtoria e Kontrollit dhe Shërbimit të Automjeteve ka dërguar vetëm 2 herë të dhënat për numrin e automjeteve për

Qarkun e Lezhës. Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit, Lezhë ka dërguar vetëm 1 herë të dhëna. Fabrika e tullave sh.p.k. ka dërguar 6 vetëmonitorime për treguesit e ndotësve të shkarkimit në ajër. Fabrika e përpunimit të peshkut "Poseidon" ka dërguar 3 monitorime dhe fabrika e përpunimit të peshkut, 2 monitorime.

Subjektet që kanë dërguar vetëmonitorimet pranë ARM-së, si dhe analizat e kryera nuk pasqyrojnë plotësisht të dhënat mbi gjendjen dhe përputhshmërinë me kushtet e vëna në lejen mjedisore apo kufirin e standardeve që ato duhet të plotësojnë. Të dhënat e dërguara nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor e rrethit Laç, për mjetet e transportit pasqyrojnë vetëm numrin e automjeteve, klasifikimin e tyre dhe llojin e karburantit që ato përdorin. Nga të dhënat për vitin 2005 rezultojnë gjithsej 1608 automjete, nga të cilët 1491 përdorin karburant naftë ose gazoil dhe 117 përdorin karburant benzinë. Nga ana e kësaj drejtorie nuk është raportuar mbi nenet 5 dhe 6, të udhëzimit nr. 6527, datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore".

Fabrika e Tullave e cila ka shkarkuar ndotës në atmosferë mbi normat e lejuara, me përmirësimin teknologjik si dhe të karburantit si lëndë djegëse ka përmirësuar dhe është nën kufijtë e përcaktuar të elementeve ndotës që shkarkohen në atmosferë.

Fabrika e përpunimit të peshkut sh.p.k. ka përmirësuar parametrat e shkarkimeve në ujërat sipërfaqësor, pasi ka vënë në funksionim skemën e pastrimit të ujërave.

Fabrika e përpunimit të peshkut sh.p.k., në bazë të monitorimit dhe analizave të kryera në shkarkimet e ujërave të ndotura rezulton se këto shkarkime janë brenda normave të lejuara.

Për vitin 2006 u konstatua se kanë dërguar pranë ARM-së, vetëmonitorimin dhe raportin e vetëmonitorimit 13 subjekte, nga të cilat 6 subjekte shtetërore dhe 7 subjekte private. Në subjektet shtetërore bëjnë pjesë:

- Drejtoria e përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor e cila ka dorëzuar 3 raporte, ku jep të dhëna mbi numrin e përgjithshëm të automjeteve për rrethet Lezhë, Laç, Mirditë.

- Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit ka dorëzuar 2 raporte, ku jep të dhëna mbi erozionin dhe ndotjen në qark.

- Bashkia Lezhë ka dorëzuar 2 raporte me të dhëna mbi sasinë e mbetjeve në çdo lagje të qytetit.

- Shërbimi i Higjienës dhe Epidemiologjisë pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Kurbin ka dorëzuar 2 raporte me të dhëna mbi monitorimin e ujit të pijshëm për qytetet Laç, Mamurras e Milot.

- Bashkia Laç e cila ka dorëzuar 2 raporte mbi sasinë e mbetjeve në çdo lagje të qytetit.

- Drejtoria e Shërbimit Pyjor Lezhë e cila ka dorëzuar 1 raport 8-mujor mbi të dhënat në lidhje me kundravajtje penale e administrative, sëmudjet dhe masat e marra, sipërfaqet në erozion, numrin e zjarreve dhe sipërfaqet e shpyllëzuara si dhe projektet e realizuara.

Në subjektet private bëjnë pjesë:

- Fabrika e këpucëve sh.p.k. e cila ka dorëzuar 2 raporte 6 mujore të vetëmonitorimit pranë ARM-së ku tregon vetëm për mjediset e ngurta dhe se ka mbetje të ngurta, pa saktësuar sa mbetje apo çfarë lloj mbetjesh.

- Fabrika e tullave sh.p.k ka dorëzuar 3 raport analiza kryer pranë Institutit të Studimeve Ambientale në lidhje me shkarkimet në ajër të cilat rezultojnë brenda normës.

- Pika e karburantit ka dorëzuar 1 raport analizë, kryer pranë Institutit të Studimeve Ambientale në lidhje me shkarkimet në ajër, të cilat rezultojnë brenda normës.

- Fabrikat (3) e përpunimit të produkteve ihtike dorëzojnë pranë ARM-së një modular për vlerësimin e ndikimit në mjedis të aktivitetit të tyre industrial. Ato dorëzojnë gjithashtu dhe raportanalizën për ujin teknologjik të kryera pranë Inspektoriatit Sanitar Shtetëror.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor ka ushtruar kontroll dhe ka analizuar përbërjen e gazrave që emetojnë në atmosferë automjetet në 2969 prej tyre, por në asnjë rast nuk pasqyron monitorimin e përbërësve të gazrave që emetohen në ajër. Vetë kjo drejtori pohon se ka patur vështirësi: "...Gjatë kontrollit kemi patur edhe vështirësi në kohë dhe cilësi të kryerjes së analizave për arsye se aparatura ekzistuese është mjaft e vjetëruar si dhe nuk kemi kompresor për pastrimin saj...", pra siç del edhe nga ky pohim edhe kontrolli dhe monitorimi nuk është i saktë dhe në përputhje me udhëzimin e përbashkët nr. 6527, datë 24.12.2004 të ish-ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit dhe ish-ministrit të Mjedisit.

Grupi i kontrollit konstatoi se subjektet fizike dhe juridike të cilat kanë detyrimin ligjor për të kryer vetëmonitorimin dhe dërgimin e të dhënave të paktën 4 herë në vit pranë ARM-së, nuk është realizuar për vitet 2004, 2005 dhe ka një përmirësim në këtë drejtim për vitin 2006 (maj-dhjetor).

ARM-ja në disa raste iu ka dërguar shkresë zyrtare subjekteve për plotësimin e detyrimit ligjor të dërgimit nga ana e tyre të vetëmonitorimeve pranë ARM-së, por nga ana e këtyre subjekteve nuk është plotësuar detyrimi ligjor.

ARM-ja dhe inspektorët nuk kanë zbatuar pikën 2, germa "ç", të nenit 82 (Sanksionet), të ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", si dhe të ligjeve të tjera specifike ndaj subjekteve që nuk kanë dërguar ose që kanë dërguar pjesërisht të dhëna mbi vetëmonitorimin.

Pranë ARM-së, Qarku Lezhë nuk u gjet asnjë e dhënë që të ishte dërguar nga subjektet e pajisura me leje apo autorizim mjedisor, për rrethet Kurbin e Mirditë, mbi vetëmonitorimet.

Pranë kësaj ARM-je nuk u gjet evidencë ku të ishin pasqyruar subjektet që shkaktojnë ndotje dhe dëmtim në mjedis si dhe natyra specifike e grupuar, për çdo subjekt, sipas natyrës së ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit.

Monitorimi i mjedisit edhe për ato subjekte që kanë dërguar të dhënat nuk është krahasuar me përmbajtjen dhe detyrimet që janë vënë në lejen apo autorizimin mjedisor.

Subjektet aktiviteti i të cilave ka ndikim të lartë dhe të mesëm në mjedis dhe shkaktan dëmtim të mjedisit si karrierat e gurit, karrierat lumore, nyjet e betonit, fabrikat e këpucëve, nyjet e prodhimit të inertëve nga guri gëlqeror, përpunim mermeri, mbetjet dhe shkarkimet urbane etj., nga ana e ARM-së nuk janë detyruar të kryejnë vetëmonitorimin në përputhje me ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit". Për sa u trajtua, për moszbatim të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 si dhe të VKM nr. 103, datë 31.03.2002 mbajnë përgjegjësi dy kryetaret per periudhat perkatese 01.01.2004 - 12.05.2006 dhe 13.05.2006-31.12.2006.

C. Në zbatim të pikës 1, neni 69, neni 71, të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", ARM, Qarku Lezhë gjatë vitit 2004, 2005, 2006 ka

ushtruar gjithsej 383 aktkontrolle dhe 202 aktverifikime në subjektet të cilat janë pajisur me leje mjedisore e autorizim mjedisor.

Për vitin 2004 janë kryer 136 aktkontrolle dhe 56 aktverifikime. Pranë ARM-së u gjetën aktkontrolle dhe aktverifikime vetëm për rrethin e Lezhës, për rrethet Kurbin dhe Mirditë nuk u vu në dispozicion dokumentacion që të pasqyronte punën e kryer për këtë vit. Në shumicën e rasteve të mbajtjes së aktkontrolleve për vitin 2004, subjektet për të cilat janë mbajtur aktkontrolle kanë qenë pika të shitjes së karburanteve me pakicë, servis automjetesh, depozita karburantesh, fabrika këpucësh, karriera guri, etj.

Në 3 subjektet e përpunimit të peshkut janë kryer 6 aktkontrolle, ku më specifiku është kryer në datë 04.3.2004, ku ka ushtruar kontroll në aktivitetin e stabilimentit të firmës sh.p.k., për shkarkimin e ujërave të ndotura në fshatin Torovicë ku ka konstatuar se shkarkimi i ujërave dhe llumrave në përbërje të tyre të dalë gjatë procesit teknologjik kanë qenë mbi normat e lejuara dhe të shoqëruara me aromë mbytëse. Për sa më sipër kanë përbërë shqetësim të dukshëm për banorët, si dhe objekt i ndotjes së madhe në mjediset pritëse të këtyre shkarkimeve. Nga ana e ARM dhe Ministrisë janë marrë masa për pezullimin e veprimtarisë deri në sjelljen në parametra normalë të këtyre shkarkimeve. Masat e marra në vijim nga subjekti kanë përmirësuar situatën dhe e kanë sjellë atë në parametra të lejueshme.

Për vitin 2005 janë kryer 154 aktkontrolle dhe 143 aktverifikime në shkallë qarku. Pranë ARM-së u gjetën aktkontrolle dhe aktverifikime vetëm për rrethin e Lezhës, për rrethet Kurbin dhe Mirditë nuk u vu në dispozicion dokumentacion që të pasqyronte punën e kryer për këtë vit. Në 72 të rasteve të mbajtjes së aktkontrolleve, për vitin 2005 subjektet për të cilat janë mbajtur aktkontrolle kanë qenë pika të shitjes së karburanteve me pakicë, servis automjetesh, depozita karburantesh, fabrika këpucësh, karriera guri etj. Theksojmë se aktkontrollat janë shtrirë gjatë gjithë vitit.

Për vitin 2006 janë kryer 93 aktkontrolle dhe 3 aktverifikime në shkallë qarku. Nga këto 34 aktkontrolle janë kryer në karriera lumore, 26 aktkontrolle në pika të ndryshme karburanti, 13 aktkontrolle në karrierat e gurit, 6 aktkontrolle në fabrikat e përpunimit të peshkut dhe 34 aktkontrolle në subjekte të tjera si nyje fraksionimi të inerteve lumore, nyje betoni, fabrika këpucësh, fabrika tullash, auto servise, foto studio, prodhime buke, karriera mermeri etj. Aktverifikimet e lartpërmendura janë kryer të treja në pika të ndryshme karburanti. Periudha e kryerjes së këtyre aktkontrolleve është e shtrirë gjatë gjithë vitit.

Në datën 17.12.2006, në Lagunën e Knallës, zonë e mbrojtur, Shëngjin Lezhë, u konstatua ndotja e Lagunës në një sipërfaqe prej 50 ha, si rezultat i shpërthimit të depozitave të karburantit të firmës private, nga ku u shkarkuan në mjedisin përreth 1100 ton naftë dhe 170 ton benzinë. Si pasojë e këtij fenomeni pati dëmtime në bimësinë ujore, kallamishte, bimë gaminore, bimë shkurre etj., ndërsa në faunë u konstatuan 5 shpendë ujorë të ngordhur si dhe largime të përkohshme të shpendëve nga kjo pjesë e lagunës. Me masat e marra u arrit të bëhet kufizimi i plotë i sipërfaqes së ndotur me anë të ndërtimit të argjinaturës mbrojtëse me gjatësi 40 m. Aktualisht gjendja është nën kontroll dhe e përmirësuar.

Grupi i kontrollit konstatoi se aktkontrollat që janë mbajtur nuk i referohen zbatimit të kërkesave dhe detyrimeve që janë përcaktuar në lejen apo autorizimin mjedisor. Në asnjë pikë apo detyrë të lënë në aktkontrolle nuk i referohet në mënyrë specifike pikave të përcaktuara në lejen apo autorizimin mjedisor.

Nga verifikimet e bëra mbi zbatimin e kushteve të vendosura në lejet apo autorizimet mjedisore, detyrimet e subjektit janë përcaktuar në mënyrë të përgjithshme dhe pa përcaktuar normat e shkarkimit në çdo nyje shkarkuese të veprimtarisë dhe në total, duke i cituar normat e shkarkimeve. Nuk janë përcaktuar kërkesat për zbatimin e programit të monitorimit duke përfshirë treguesit e gjendjes së ndikimit, stacionet e marrjes së mostrës dhe frekuencën e matjes së tyre, metodën e matjes ose të llogaritjes si dhe të regjistrimit të të dhënave etj. Nuk janë përcaktuar masat dhe afatet për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar ose të ndotur, masa për trajtimin e mbetjeve dhe mbetje të rrezikshme që krijojnë veprimtaria dhe masat e detyrueshme restauruese në rast mbyllje të veprimtarisë si dhe detyrimi për kryerjen e vlerësimit mjedisor, veprime të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, VKM nr. 249, datë 24.4.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementëve të lejes mjedisore”. Të gjitha këto kërkesa e të tjera nuk janë pasqyruar në lejet apo autorizimet mjedisore gjë që e bën të vështirë kontrollin, inspektimin, vetëmonitorimin si dhe të impaktit që sjell në mjedis kjo veprimtari.

Të gjitha subjektet e pajisura me leje mjedisore për shfrytëzim të karrierës për nxjerrjen e gurit gëlqeror që janë në aktivitet dhe nuk i ka mbaruar afati i lejes mjedisore nuk kanë paraqitur pranë ARM-së planin e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret, kërkesë kjo e udhëzimit nr. 3, datë 17.5.2006, e cila duhet të ishte plotësuar brenda 2 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. ARM-ja nuk ka marrë asnjë masë detyruese që subjektet të paraqisnin këtë plan rehabilitimi brenda afateve. ARM-ja si dhe inspektorati i mjedisit pranë saj nuk kanë pezulluar punimet deri në dorëzimin e planit të rehabilitimit nga subjektet. Subjekti privat ka pasur aktivitet të shfrytëzimit të karrierës për nxjerrjen e gurit gëlqeror dhe ka qenë i pajisur me leje mjedisore, afati i së cilës ka përfunduar më 12.07.2000, në vendndodhjen Sakë, Shëngjin, Lezhë, aktivitet të cilin e ka mbyllur por nuk e ka rehabilituar habitatin që ka dëmtuar dhe nuk është detyruar për ta rehabilituar atë duke zbatuar kërkesat e këtij udhëzimi apo të detyrohej me rrugë gjyqësore, veprim i cili bie në kundërshtim me pikën 5, të udhëzimit nr. 3, datë 21.06.2006.

Në ARM, Qarku Lezhë nuk u gjet plani i rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga shfrytëzimi i inerteve në shtretërit dhe brigjet e lumenjve, si dhe projekti i rehabilitimit, afatet kohorë për kryerjen e punimeve dhe kostot përkatëse, masat për parandalimin e erozionit, për gjelbërimin dhe rigjelbërimin si dhe ndërhyrjet e vazhdueshme për mirëmbajtjen e veprave inxhinierike të ndodhura pranë tyre, pjesë të kërkesave që përmban vendimi i Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 3, datë 21.06.2006 “Për rehabilitimin e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve të dëmtuara nga shfrytëzimi i inerteve”. Subjektet që ushtrojnë aktivitet në shfrytëzimin e karrierve lumore dhe që lejen e shfrytëzimit e ripërtërijnë për çdo vit në dosjet që disponon ARM-ja nuk u gjetën për vitin 2007 plane të rehabilitimit të shtretërve dhe brigjeve të lumenjve. Për moszbatim të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002, ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003, VKM nr. 249, datë 24.04.2003, udhëzimit nr. 3, datë 17.05.2006 si dhe VKKU nr. 3, datë 21.06.2006, mbajnë përgjegjësi kryetaret sipas periudhave perkatëse.

### *Mbi kontrollin e aplikimit të gjobave dhe arkëtimit të tyre*

Gjatë vitit 2004 nuk është aplikuar asnjë gjobë nga ana e inspektoriatit të mjedisit pranë ARM Qarku Lezhë. Në zbatim të nenit 71, të ligjit nr. 8934, datë

05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, si dhe të pikës 1, neni 86, të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, nga ARM, Qarku Lezhë, për vitin 2004 janë bërë përpjekje për të vjelë gjobat e vëna 6 subjekteve: 3 shpërndarës karburanti, më datë 28.05.2003, 1 per linjë inerte, datë 29.05.2003, 2 per linja inertesh, datë 30.05.2003, të cilat kryenin aktivitetin e tyre pa u pajisur me leje mjedisore.

Më datën 09.02.2004, ARM, Qarku Lezhë ka marrë vendimin me nr. 1/2 prot., në të cilin ka vendosur të bllokojë aktivitetin e firmave deri në plotësimin e dokumentacionit për zhvillimin e aktivitetit të tyre si dhe likuidimin e gjobës.

Në përputhje me nenet 73, 74, të ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” me shkresën nr. 532, datë 14.4.2004, kërkohet bashkëpunim për zbatimin e legjislacionit, institucionit të prefektit, Bashkisë Lezhë si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimtaksave. Si rezultat i njoftimit të bërë me shkresën nr. ½, datë 09.02.2004, pranë Inspektoriatit të Mjedisit, më datë 25.05.2004, me shkresën nr. 159 prot, ka dalë urdhri nr. 87, datë 25.5.2004 “Për pezullimin e veprimtarisë të 6 personave juridike sh.p.k., në zbatim të pikës 3, neni 44 dhe pikës 1, neni 86, të ligjit nr. 8934 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit, gjobat e sipërpërmendura nuk janë arkëtuar nga subjektet përkatëse si dhe nuk ka dokumentacion ku të vërtetohej pezullimi i veprimtarisë. Më datë 27.4.2004 është kryer kontroll nga ana e ARM-së Lezhë në subjektin me aktivitet peshkimi në Lagunën në Vain, zona e Zajës, ku për shkeljet e konstatuara në prani të drejtorit të Shërbimit Pyjor është mbajtur procesverbali nr. 1 mbështetur në pikat 1, 2, të nenit 60, të ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe është marrë masa e ndërprerjes së aktivitetit deri në kthim në gjendjen e mëparshme të argjinaturës së objektit. Procesverbali është kthyer në vendimin nr. 1, në datë 28.4.2004. Po në këtë datë është hequr licenca, për dëmtim të grykës së ujëkëmbimit Drin-Zajë. Subjekti është njoftuar në datën 07.5.2004 dhe ka mbyllur aktivitetin.

#### Viti 2005

Nga kontrolli i dokumentacionit u konstatua se inspektorët e mjedisit pranë ARM-së së Qarkut Lezhë, nuk kanë mbajtur asnjë procesverbal për konstatimin e kundravajtjeve administrative në subjektet që shkaktojnë ndotje në mjedis. Procesverbalet e hartuara si dhe vendimet e marra janë kryer nga inspektorët e mjedisit pranë Ministrisë së Mjedisit, së bashku me inspektorët e agjencisë. Nga data 21.09.2005 deri në datën 22.09.2005 janë mbajtur gjithsej 9 procesverbale si dhe duke u mbështetur në to janë marrë 9 vendime për gjoba dhe pezullim aktiviteti.

Subjekti “person fizik” ka instaluar një nyje fraksionimi pa leje mjedisore dhe është vendosur pezullimi i këtij aktiviteti me vendim nr. 1, datë 22.09.2005; subjekti privat është gjobitur për arsye se kryen aktivitet pa leje mjedisore; subjekti sh.p.k. është dënuar me gjobë dhe pezullim aktiviteti për shfrytëzim inertesh pa u pajisur me leje mjedisore; subjekti sh.p.k. është dënuar me gjobë dhe me pezullim për ushtrim aktiviteti pa u pajisur me leje mjedisore; subjekti sh.p.k. është dënuar me gjobë dhe me pezullim aktiviteti sepse nuk i është përmbajtur kërkesave të lejes mjedisore; subjekti “person fizik” është dënuar me pezullim aktiviteti për ushtrim aktiviteti pa u pajisur me leje mjedisore; subjekti privat është dënuar me gjobë dhe me pezullim për ushtrim aktiviteti pa u pajisur me leje mjedisore; subjekti sh.p.k. është dënuar me gjobë dhe me pezullim sepse nuk i është përmbajtur kërkesave të lejes mjedisore; subjekti sh.p.k. është dënuar me gjobë për ushtrim aktiviteti pa u pajisur me leje mjedisore.

Nga dokumentacioni që disponohet, afati ligjor i pagesës së gjobës nga subjektet ka përfunduar në datë 22.10.2005, ku edhe vendimet kanë marrë formë të prerë për ekzekutim. Subjektet nuk kanë likuiduar shumën e gjobave në kohën e duhur. ARM-ja gjithë subjekteve që janë gjobitur iu bën me dije më datë 11.11.2005 që të shlyejnë detyrimin që këto subjekte kanë ndaj buxhetit të shtetit dhe me shkresë nr. 6/7, datë 14.11.2005 i është drejtuar Policisë së Rendit dhe Policisë Ndërtimore të Qarkut Lezhë. Ky njoftim i është dërguar për dijeni dhe prefektit të Qarkut Lezhë, si dhe kryeinspektorit të Mjedisit pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Me gjithë njoftimin e këtyre strukturave, gjobat kanë mbetur të pavjela deri në fund të vitit 2005 dhe sipas të dhënave, rezultoi se vetëm firma ka likuiduar gjobën me shumën prej 300 000 lekësh me nr. 0102030780, datë 27.3.2006 pranë bankes sh.a. Edhe pse subjektet janë njoftuar si më sipër nuk është bërë likuidimi i gjobës dhe ARM më datë 06.03.2006 iu ka dërguar shkresë zyrtare gjithë subjekteve të cilat kanë detyrim likuidimin e gjobës si dhe penalitetet. Deri në ditën e kontrollit, këto detyrime nuk janë shlyer nga subjektet në fjalë. ARM-ja në bazë të nenit 86 të ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” duhet të njoftonte kryeinspektorin ose ministrin të cilët të urdhëronin pezullimin ose mbylljen e përhershme të veprimtarisë ose të zbatonin nenin 82, pika 1, të ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Theksojmë se nuk disponohet informacion nëse këto subjekte e kanë pezulluar aktivitetin e tyre në bazë të procesverbaleve të hartuara nga Inspektoriati i Mjedisit.

#### Viti 2006

Për vitin 2006, ARM ka vendosur tre gjopa në 3 subjektet: me aktivitet pastrimin e qytetit, autoservis, karburant, që ushtrojnë aktivitet në qytetin e Lezhës.

Në datën 30.01.2006, ARM, Qarku Lezhë ka kryer kontroll në zbatim të pikës 1, neni 82, ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, në subjektin sh.p.k. me aktivitet “Pastrim i qytetit Lezhë”, ku ka konstatuar shkarkime të mbetjeve urbane në mospërputhje me kushteve e vëna në lejen mjedisore.

Për këtë veprim, ARM-ja ka mbajtur procesverbal në dt. 30.01.2006, për konstatim e kundravajtje administrative. Në datën 27.3.2006, ARM-ja ka marrë vendimin nr. 1, për dënimin me gjobë 50 000 lekë subjektin sh.p.k., në zbatim të pikës 4, germa “g”, të nenit 82, të ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Me shkresën nr. 7/1, datë 01.02.2006, ARM i ka bërë njoftim subjektit sh.p.k., ku e vë në dijeni për vendimin e dënimit me gjobë për shkarkimet abuzive në vende të pamiratuara të mbeturinave urbane të evaduara nga pastrimi i qytetit Lezhë. Në rast mosrespektim, ARM do të përshkallëzojë sanksionet ligjore.

Subjekti sh.p.k. nuk ushtron më aktivitet dhe nuk ka arkëtuar shumën e gjobës.

Në zbatim të pikës 1, neni 82, ligjinr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, në datën 27.03.2006, ARM, Qarku Lezhë ka kryer kontroll në subjektin sh.p.k me aktivitet auto servis”, ku ka konstatuar se subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna në aktkontrollin e datës 20.12.2005 dhe vazhdon të ushtrojë aktivitet pa u pajisur me leje mjedisore. Në datën 27.03.2006 është marrë vendimi nr. 1, për dënimin me gjobë 50 000 lekë, subjektin sh.p.k. Nuk u gjetën të dhëna nëse gjopa e vendosur është arkëtuar.

Në subjektin sh.a. me aktivitet “tregtim karburantesh me shumicë”, inspektorët kanë konstatuar se subjekti nuk ka zbatuar kushtet e lejes për pikën “Monitorime” dhe dërgimin e të dhënave pranë ARM, çdo tre muaj. Për këtë veprim është mbajtur procesverbal në dt. 30.06.2006, për konstatim e kundravajtje administrative dhe me vendimin nr. 1, datë 30.06.2006, ka dënuar me gjobë 10 000 lekë, subjektin sh.a., për moszbatim të pikës 4, germa “g”, të nenit 82, të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Sipas verifikimit, kjo gjobë është arkëtuar në datën 05.08.2006, me mandatarkëtimi nr. 12.

Shuma e gjobave të paarkëtuara për vitet 2004, 2005, 2006 është 2 110 000 lekë, shumë e cila nuk është arkëtuar dhe nuk mund të ekzekutohet, pasi sipas nenit 23, të ligjit nr. 7697, datë 07.4.1993, me ndryshime “Për kundravajtje administrative”, nuk mund të ekzekutohen gjobat me kalimin e një viti nga data e dhënies së tyre.

ARM, Qarkut Lezhë nuk duhet të bënte shqyrtimin fillestar të dokumentacionit për subjektet në fjalë pa derdhur shumën e gjobave të mësipërme, gjë që bie në kundërshtim me nenet 85, 86, të ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002. Nga verifikimi i dokumentacionit pranë ARM, Qarku Lezhë konstatohet se subjekti (karburant) është pajisur me leje mjedisore datë 26.02.2007, subjekti (karburant) është pajisur me leje mjedisore më datë 06.02.2006, 4 subjektet sh.p.k. (shfrytëzim inertesh lumore), subjekti (nyje fraksionimi inertesh lumore), subjekti sh.p.k. (shfrytëzim gurore), janë pajisur me leje mjedisore. Subjekti sh.p.k. (auto servis) është pajisur me leje mjedisore, subjekti tjetër sh.p.k ka mbyllur aktivitetin. 4 Subjektet (1 karburant) linja inertesh si dhe aktiviteti “peshkim”, në lagunën Vain kanë mbyllur aktivitetin. Për shqyrtimin e dokumentacionit dhe pajisjen me leje mjedisore për subjektet të cilat nuk kanë arkëtuar shumën e gjobave mbajnë përgjegjësi ish-kryetari i ARM-së, Qarku Lezhë dhe ish-kryetari i ARM-së, Qarku Lezhë, veprim i cili bie në kundërshtim me nenet 85,86, të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002.

### *Mbi arkëtimet e tarifës për deklaratën, lejen, autorizimin dhe pëlqimin mjedisor*

#### *a. Mbi arkëtimin e tarifës për deklaratën mjedisore*

Në ARM, Qarku Lezhë për vitet 2004, 2005, 2006 nuk ka patur raste ku ministri të ketë shpallur qendrim zyrtar me deklaratën mjedisore pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe këshillimit me palët e interesuara për projektet strategjike dhe planet e zhvillimit në territorin e qarkut, dhe për rrjedhojë nuk ka patur raste, të arkëtimin të tarifës për deklaratën mjedisore.

#### *b. Mbi arkëtimin e tarifës së shërbimit për dhënien e lejes mjedisore.*

Nga dokumentacioni shkresor vënë në dispozicion të grupit të kontrollit u konstatua se pranë kësaj Agjencie nuk ndodhen kopje të dokumentacionit si dhe të dokumentit që vërteton derdhjen e tarifës nga subjektet që kanë aplikuar për tu pajisur me leje mjedisore. Në vitet 2004, 2005 dhe 2006 janë pajisur me leje mjedisore 65 subjekte, nga të cilat për vitin 2004, 27 subjekte, për vitin 2005, 12 subjekte dhe për vitin 2006, 25 subjekte. Për vitin 2006 u gjetën 4 mandatarkëtime për leje mjedisore nga 25 të aplikuara gjithsej. Nga shpjegimet e dhëna nga ish-kryetarët e ARM, del se dokumentacioni për dhënien e lejes mjedisore si dhe arkëtimet e tarifave për aplikim për dhënien e lejes mjedisore janë kryer në rrethet Lezhë, Kurbin e Mirditë, nga kryetari i ARM-së dhe inspektorët e këtyre rretheve

dhe janë përcjellë për në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave pa mbajtur kopje të dokumentacionit dhe dokumentin e arkëtimit të tarifës për lejet mjedisore.

*c. Mbi arkëtimin e tarifave për autorizimet dhe pëlqimet mjedisore.*

Për vitin 2004, në zbatim të nenit 43, të ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, nenit 30 të ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, udhëzimit nr. 1, datë 08.02.2000 “Për tarifën e shërbimit për lejet mjedisore”, janë pajisur me autorizim mjedisor dhe leje mjedisore 83 subjekte, prej të cilave 4 janë autorizime mjedisore që i përkasin qytetit të Laçit dhe 79 prej tyre janë pëlqime mjedisore të qytetit të Lezhës. Për periudhën janar-mars janë arkëtuar 22 pëlqime mjedisore në Ministrinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave me mandatarkëtimin nr. 279, datë 26.08.2004, vlera 11000 lekë, për periudhën korrik-shtator janë arkëtuar 40 pëlqime mjedisore në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave me mandatarkëtimin nr. 743, datë 18.10.2004, vlera 20 000 lekë, për periudhën tetor-dhjetor janë arkëtuar 21 pëlqime mjedisore në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave me mandatarkëtimin nr. 836, datë 17.12.2004, vlera 10 500 lekë, të gjitha arkëtimit të cilat janë kryer në arkën e MMPAU i përkasin qytetit të Lezhës dhe rolin e arkëtarit e ka kryer kryetari i ARM.

Nga verifikimi që iu bë mandatpagesave dhe vendimeve të marra nga ARM-ja, për vitin 2004, rezultoi se: në vendimin nr. 1, datë 02.10.2004 janë miratuar për t'u pajisur me pëlqim mjedisor 9 subjekte të qytetit të Lezhës dhe me autorizim mjedisor 4 subjekte të cilat i përkasin rrethit të Kurbin, konkretisht subjekti “Istogu” dhe subjekti “Bardhi” të cilat pastrojnë qytetin e Mamurrasit dhe qytetin e Laçit nga mbeturinat urbane, si dhe dy subjekte të personave fizikë të cilët kryejnë aktivitetin e servisit të automjeteve në qytetin e Mamurrasit. Në vendimin nr. 2, datë 14.12.2004 janë miratuar 5 pëlqime mjedisore për qytetin e Lezhës. Diferenca me 65 pëlqime mjedisore midis mandatarkëtimeve dhe vendimeve të marra nga ARM-ja ekziston sepse në periudhën 1 janar deri në 30 shtator 2004, ARM Lezhë ka miratuar dokumentacion për lejet, autorizimet dhe pëlqimet mjedisore pa marrë vendime në kundërshtim me ligjin nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Në tabelën nr. 6 janë pasqyruar arkëtimet vetëm për rrethin e Lezhës, 4 autorizimet e miratuara në vendimin nr. 1, datë 02.10.2004 nuk kanë të pasqyruar në vendim numrin e mandatarkëtimit dhe datën e prerjes së këtij mandatarkëtimit.

Subjektet që kanë aplikuar për autorizim dhe pëlqim mjedisor për rrethin Kurbin dhe Mirditë, arkëtimet i kanë kryer pranë inspektorëve përkatës të cilët i kanë arkëtuar pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, por që nga ana e tyre nuk na u paraqitën dokumentacione që të vërtetonin arkëtimet e derdhura në MMPAU.

Gjatë vitit 2005 ARM-ja e Qarkut Lezhë ka marrë gjithsej 11 vendime ku ka aprovuar dhe iu ka dhënë autorizim mjedisor 12 subjekteve dhe pëlqim mjedisor 58 subjekteve.

Nga verifikimi që iu bë vendime të miratuara për autorizim mjedisor dhe arkëtimet e tyre, për vitin 2005 janë paraqitur në tabelën nr. 7.

Për subjektet e pasqyruar në këtë tabelë nuk u gjetën mandatarkëtimet të cilat të vërtetonin pagesën e kryer prej tyre, në 9 raste në shumën e përgjithshme prej 180 000 lekësh.

Në tabelën nr. 10 janë pasqyruar arkëtimet vetëm për rrethin e Lezhës. Arkëtimet për rrethet Kurbin dhe Mirditë nuk na u vunë në dispozicion me

arsyetimin se arkëtimet janë bërë pranë rretheve përkatës nga inspektorët përkatës, të cilët i kanë arkëtuar pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, por që nga ana e tyre nuk u paraqit dokumentecioni që vërteton arkëtimet e derdhura pranë MMPAU.

#### *Viti 2006*

Për vitin 2006 nga ARM Qarkut Lezhë janë marrë gjithsej 9 vendime, për miratimin e autorizimeve dhe pëlqimeve mjedisore. Për periudhën janar-qershor 2006 janë marrë gjithsej 3 vendime. Gjatë kësaj periudhe janë pajisur me autorizim mjedisor 18 subjekte dhe me pëlqim mjedisor 21 subjekte, ndërsa për numrin e subjekteve të pajisur me leje mjedisore gjatë kësaj periudhe nuk ka të dhëna. Gjatë periudhës qershor-dhjetor 2006, janë marrë gjithsej 6 vendime dhe janë pajisur me autorizim mjedisor 13 subjekte, me pëlqim mjedisor 120 subjekte dhe me leje mjedisore 25 subjekte.

- Në vendimin nr. 12 i marrë në datën 09.01.2006, iu është dhënë leje 9 subjekteve, prej të cilave 8 janë pëlqime mjedisore dhe 1 autorizim mjedisor. Në këtë vendim nuk janë pasqyruar datat në të cilat janë kryer arkëtimet përkatëse.

- Në vendimin nr. 1, marrë në datën 06.02.2006, iu është dhënë leje 14 subjekteve, nga të cilat 8 pëlqime mjedisore dhe 6 autorizime mjedisore. Në këtë vendim nuk është pasqyruar mandatarkëtimi për 6 subjekte (autorizime mjedisore).

- Në vendimin nr. 2 i marrë në datën 09.03.2006, u është dhënë leje 14 subjekteve, nga të cilat 7 pëlqime mjedisore dhe 8 autorizime mjedisore. Në këtë vendim nuk është pasqyruar mandatarkëtimi për 8 subjekte (autorizime mjedisore).

- Në vendimin nr. 1, i marrë në datën 31.07.2006, u është dhënë autorizim mjedisor 5 subjekteve, për të cilat mandatarkëtimet u gjetën bashkëngjitur vendimit.

- Në vendimin nr. 2, nr. 6 prot., i marrë në datën 30.08.2006, i është dhënë autorizim mjedisor 1 subjekti, për të cilin mandatarkëtimi u gjet bashkëngjitur vendimit.

- Në vendimin nr. 3, i marrë në datën 04.09.2006, nr. 7-9 prot., u është dhënë autorizim mjedisor 3 subjekteve, për të cilat mandatarkëtimet u gjetën bashkëngjitur vendimit.

- Në vendimin nr. 4, nr. 10 prot., i marrë në datën 30.11.2006, i është dhënë autorizim mjedisor 1 subjekti, për të cilin mandatarkëtimi u gjet bashkëngjitur vendimit.

- Në vendimin nr. 5, nr.11 prot., i marrë në datën 15.12.2006, i është dhënë autorizim mjedisor 1 subjekti, për të cilin mandatarkëtimi u gjet bashkëngjitur vendimit.

- Në vendimin nr. 6, i marrë në datën 27.12.2006, nr. 12-13 prot., u është dhënë autorizim mjedisor (përtëritje e autorizimit mjedisor) 2 subjekteve, për të cilat mandatarkëtimet u gjetën bashkëngjitur vendimit.

Lista e objekteve të miratuara për periudhën janar 2006 përmban 7 pëlqime mjedisore. Duke bërë krahasimin me vendimin nr. 1, datë 02.02.2006, i cili miraton objektet për periudhën janar 2006, 1 prej këtyre subjekteve të pajisura me pëlqim mjedisor nuk figuron në këtë vendim.

Lista e objekteve të miratuara për periudhën shkurt 2006 përmban 10 pëlqime mjedisore. Duke bërë krahasimin me vendimin nr. 2, datë 02.02.2006, i cili miraton objektet për periudhën janar 2006, 3 prej këtyre të pajisura me pëlqim mjedisor nuk figurojnë në këtë vendim.

Lista e objekteve të miratuara për periudhën mars 2006 përmban 19 pëlqime mjedisore.

Nga kontrolli u konstatua se iu është dhënë pëlqim mjedisor 141 subjekteve, për të cilat nuk u gjetën vendimet apo material shkresor ku të ishte analizuar dhe dhënë pëlqimi mjedisor për këto subjekte.

Për periudhën janar–mars 2006 nuk figuron asnjë mandatarkëtimi që të vërtetojë derdhjen e tarifës së mbledhur nga kryetari i ARM-së, për autorizimet mjedisore pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave me një vlerë totale prej 280 000 lekësh. Gjatë kësaj periudhe janë dhënë gjithsej 12 raste autorizime, me tarifë 20 000 lekë, gjithsej 240 000 lekë si dhe 4 raste ripërtëritje të autorizimit mjedisor me tarifë 10 000 lekë, gjithsej 40 000 lekë.

Gjithë procedura që është aplikuar nga ARM si dhe inspektorët e mjedisit të rretheve Kurbin dhe Mirditë është në kundërshtim me udhëzimin nr. 1, datë 08.02.2000 “Për tarifën e shërbimit për lejet mjedisore”, urdhrin e ministrit nr. 4, datë 07.02.2001 “Për tarifë vule”, si dhe udhëzimin nr. 1, datë 30.11.2005 “Për tarifën e shërbimit për lejet mjedisore” ku në mënyrë të qartë në pikën 6 theksohet:

Tarifa derdhet nga propozuesi në bankë, në adresën: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Raiffeisen Bank, nr. llogarie 317/4302, përkrahimi; tarifë për deklaratë mjedisore, leje mjedisore, autorizim mjedisor ose pëlqim mjedisor (sipas rastit). Për moszbatim të udhëzimit nr. 1, datë 08.02.2000, të urdhrin të ministrit nr. 4, datë 07.02.2001, si dhe të udhëzimit nr. 1, datë 30.11.2005 mbajnë përgjegjësi kryetarët e ARM, Qarku Lezhë, sipas periudhave përkatëse.

*Mbi zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta midis Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, me inspektoriatet e institucioneve të tjera, për inspektimin e integruar*

Në zbatim të neneve 60 e 61, të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ministria e Mjedisit ka hartuar draftin e 11 marrëveshjeve dhe udhëzimeve të përbashkëta të bashkëpunimit me inspektoratet e 11 dikastereve të tjera shtetërore. Në këto marrëveshje përcaktohet përgjegjësia e çdo dikasteri në inspektimin e veprimtarive specifike sektoriale që kryhen në vendin tonë. Në mbështetje të paketës ligjore për mjedisin, inspektimi i përbashkët bëhet më efikas, nëpërmjet bashkëpunimit midis inspektoriatit të mjedisit dhe inspektoriateve të tjera.

Në ARM, Qarku Lezhë nuk u gjetën programe të veçanta të hartuara midis Inspektoriatit pranë ARM Lezhë dhe inspektoriatit të specializuar që veprojnë në Qarkun e Lezhës. Grupi i punës konstatoi se për vitin 2004 nuk është kryer asnjë kontroll i përbashkët midis inspektorëve të mjedisit pranë ARM Lezhë dhe inspektorëve të specializuar sipas draft marrëveshjeve të hartuara midis Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe institucioneve të tjera qendrore.

Për vitin 2005 janë kryer inspektime të përbashkëta me MNZZH, gjithsej 5 kontrolle, 2 kontrolle të ushtruara në pikat e karburantit, me Inspektoriatin Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre, 2 kontrolle të ushtruara me Inspektoriatin Sanitar Shtetëror në pika karburanti si dhe 1, në fabrikën e peshkut në Shëngjin.

Në periudhën qershor-dhjetor të vitit 2006 janë kryer 17 inspektime të përbashkëta me Agjencinë Ujore të Baseneve, Lezhë, kontrolle të cilat janë ushtruar në karriera lumore dhe janë mbajtur 17 procesverbale, duke lënë si

detyrë pajisjen me leje mjedisore për ato subjektet që nuk i kishin ato si dhe rehabilitimin e karrierës së tyre.

Konstatohet se edhe pse janë mbajtur procesverbale për shkak të dëmtimit të mjedisit në rastet e sipërpërmendura, nga inspektorët nuk janë vendosur masa detyruese si dhe gjobitja e tyre.

Konstatohet se për problemet e ngritura në procesverbal, nga ana e ARM-së nuk është ndjekur realizimi i këtyre detyrave nga subjektet.

Impakti i këtyre inspektimeve të përbashkëta në përmirësimin e gjendjes mjedisore në subjektet e kontrolluara dhe kthimin e tyre në parametrat e përcaktuar në lejen, autorizimin mjedisor, është jo efektiv.

Pranë ARM, Qarku Lezhë nuk u gjet asnjë program i përbashkët inspektimi midis ARM-së, Policisë së Qarkut dhe inspektoriateve të tjera të cilat kryejnë veprimtari e tyre në Qarkun e Lezhës.

Konstatohet se veprimtaria e ARM-së, në vitet 2004, 2005, 2006, për zbatimin e neneve 60 e 61, të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” është shumë e kufizuar.

Në zbatim të ligjit nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” nuk janë kryer inspektime të përbashkëta midis ARM-së dhe inspektoriateve të tjera për: mbetjet urbane, mbetjet industriale, mbetjet spitalore, mbetjet e ndërtimit, mbetjet në sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza, kanaleve kulluese e rezervuarëve, mbetjet bujqësore e blegtorale, mbetjet e vëllimshme.

Në zbatim të ligjit nr. 8905, datë 06.06.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi” nuk janë bashkërenduar punët dhe kryer inspektime të përbashkëta midis ARM-së dhe Inspektoriatit të Peshkimit, me Policinë e Shtetit dhe Rojën Bregdetare të Republikës së Shqipërisë, si dhe nuk janë koordinuar kontrole dhe inspektime për zbatimin e ligjit nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, ligjit nr. 8897, datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”.

Për problemet e trajtuara konstatohet se mungesa e planeve dhe programeve të përbashkëta midis ARM-së, Policisë së Shtetit dhe inspektoriateve specifike apo organeve të ngarkuara me ligj si dhe përcaktimi i subjekteve që do të kontrollohen, tregon mungesë efikasiteti dhe autoriteti në zbatimin e detyrave nga ana e ARM.

### *Të ndryshme*

*a. Mbi strukturën dhe funksionimin e ARM-së, Qarku Lezhë, në zbatim të neneve 69, 70, 71 të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”.*

Nga kontrolli që iu bë aktivitetit të ARM-së u konstatuan të meta dhe dobësi të cilat bien në kundërshtim me legjislacionin e miratuar për mjedisin, si më poshtë:

- ARM Qarku Lezhë nuk ka administratë, ajo funksionon vetëm me kryetarin e saj. Pranë ARM-së kryejnë funksionet e tyre edhe dy inspektorë mjedisi të cilët aktivitetin e tyre të inspektimit e kryejnë në rrethet Mirditë e Kurbin, ku në këto rrethe iu është akorduar dhe buxheti përkatës.

Vëmë në dukje se pranë kësaj ARM-je i gjithë dokumentecioni i cili ka të bëjë me shqyrtimin e lejeve mjedisore, autorizimit dhe pëlqimit mjedisor nuk është i protokolluar dhe i arkivuar pranë kësaj zyre. Sipas shpjegimeve të dhëna nga ish-kryetarët e ARM-së, dokumentecioni ndodhet në të tre rrethet që përbëjnë Qarkun e Lezhës. Për Lezhën pranë ARM-së, për rrethin e Kurbinit në qytetin e Laçit, si

dhe për rrethin e Mirditës në qytetin e Rrëshenit. Ky dokumentacion administrohet nga inspektorët e mjedisit të këtyre rretheve, veprim i cili bie në kundërshtim me ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Pranë ARM, dokumentacioni i cili ka të bëjë me shqyrtimin dhe miratimin e lejes mjedisore, autorizimit dhe pëlqimit mjedisor nuk është i arkivuar sipas ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Pranë ARM-së nuk u gjet dokumentacion i veprimtarisë ku të pasqyrohej:

- data e kërkesës së subjektit që aplikon për leje mjedisore, autorizim apo pëlqim mjedisor;

- Mandat arkëtimi i pagesës për tarifën e shërbimit;

- Aktiviteti që do zhvillojë subjekti; dokumentacioni teknik);

- Data e shqyrtimit të dokumentacionit;

- Për rastin e lejes mjedisore, datën dhe numrin e protokollit, me anë të së cilës dokumentacioni është nisur për shqyrtim dhe miratim në Ministrinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;

- Ddata dhe numrin e vendimit në të cilin është miratuar nga MMPAU për ushtrimin e aktivitetit që do të kryejë si dhe datën e pajisjes me leje mjedisore, autorizim apo pëlqim mjedisor nga ARM.

Mungesa e identifikimit të gjithë procedurave që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe aprovimin e këtij dokumentacioni është veprim i cili bie në kundërshtim me ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjin nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Në procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes të dokumentacionit në ARM, Qarku Lezhë kanë marrë pjesë si përbërës të ARM-së edhe dy inspektorët e mjedisit që kryejnë detyrën e tyre në rrethet Kurbin e Mirditë, pjesë përbërëse të Qarkut Lezhë, kur shqyrtimi dhe vendimmarrja është atribut vetëm i ARM-së. Veprimi i kryer bie në kundërshtim me nenet 69, 70, 71, të ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Grupi i kontrollit konstaton se ARM e cila ka në organikë vetëm kryetarin nuk mund të shqyrtojë dokumentacionin teknik për lejet mjedisore dhe autorizim mjedisor, pasi nuk i ka kapacitetet si i vetëm të shqyrtojë dhe të marrë vendime në emër të ARM-së.

Për rrethin e Mirditës, dokumentacioni që i përket viteve 2004, 2005, 2006 nuk u vu në dispozicion, periudhë e cila i përket punës së kryer nga inspektori përkatës.

Për rrethin e Kurbinë dokumentacioni që i përket viteve 2004, 2005, deri në qershor 2006 nuk u vu në dispozicion, periudhë e cila i përket punës së kryer nga inspektori përkatës.

Për rrethin e Kurbinë, u vu në dispozicion vetëm dokumentacioni që i përket periudhës qershor-dhjetor 2006, gjatë së cilës ka ushtruar detyrën e inspektorit përkatës.

Për sa thamë më sipër veprimi i kryer nga inspektorët përkatës bie në kundërshtim me ligjin nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe VKM nr. 249, datë 24.4.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementëve të lejes mjedisore.

Nga shqyrtimi i observacioneve të ardhura për projektraportin, grupi i kontrollit konstatoi se ato janë të pa bazuara në ligj dhe në aktet nënligjore, të

pashoqëruara me dokumentacion ku të justifikohen pretendimet e ngritura. Duke u bazuar sa më sipër, grupi i kontrollit nuk i mori ato në konsideratë.

Për të metat dhe dobësitë e trajtuara në këtë raportkontrolli për periudhën nga data 01.01.2004, deri në datën 12.05.2006, për veprimtarinë e ARM mban përgjegjësi kryetari i ARM, Qarku Lezhë, si dhe inspektori perkatës në rrethin e Kurbinit. Për periudhën nga data 13.05.2006 deri më 31 dhjetor 2006, për veprimtarinë e ARM mban përgjegjësi kryetari i ARM, Qarku Lezhë si dhe për periudhën nga data 01.01.2004 deri më 31.12.2006 mban përgjegjësi inspektor perkatës në rrethin e Mirditës.

Për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, nga ana e KLSH u rekomanduan marrjen e masave konkrete për zbatim.